

VULNETARI

★ I LIRISË

Organ i Shqipetarëve në Brigadat

Internacionale


Vjeti I. -- Nr. 1

Nëntor, 1937

M A D R I D



NO
PASA-
RÁN!



VEN-
CERE-
MOS!



Keshtjella e Lirise, Varri i Fashizmes.

SALUTO! PERGEZIM!

Saluto con gioia la pubblicazione, in lingua albanese, del primo numero del Volontario della Libertà.

È questa un'altra dimostrazione dell'ampiezza sempre maggiore che prende la solidarietà internazionale verso il popolo spagnolo.

Da tutti i punti del mondo—anche dai più piccoli, anche dai più lontani—i più nobili spiriti e i più valorosi combattenti della Libertà, accorrono in Spagna, a difendere la causa comune di tutta la Umanità avanzata e progressiva.

Anche dall'Albania—piccola territorialmente, ma grande nella storia per la nobiltà dei suoi figli e le lotte combattute contro lo straniero—sono venuti in Spagna decine e decine di combattenti a riaffermare, con il loro eroismo ed il loro sangue, il secolare amore del loro popolo per la libertà e l'indipendenza delle nazioni.

Essi hanno combattuto in tutte le Brigate. In maggiore numero essi hanno combattuto nella Brigata Garibaldi, fianco a fianco con i loro fratelli italiani.

Italiani e albanesi hanno riconosciuto che qui non si combatte solo per la causa spagnola, ma si combatte anche contro il fascismo italiano, il comune oppressore, che ha fatto, della bella e fertile Italia, un paese di miseria e di schiavitù per il popolo, che ha ridotto—grazie al tradimento dei Franco Albanesi: i Zogu e simili rinnegati—la fiera Albania a una colonia italiana, punto avanzato, nei balcani, del fascismo per la preparazione di una nuova guerra.

Italiani e albanesi combattendo qui in terra di Spagna, unii nelle stesse file e per lo stesso ideale di libertà, rinnovano le più belle tradizioni dei loro paesi e seguono i comandamenti dei loro più grandi poeti e eroi nazionali.

Essi rinnovano le tradizioni gloriose del 48 e dell'epopea garibaldina, quando, gli albanesi, animati dai loro più grandi poeti come Girolamo De Rada e Pasco Vasa Pascha combatterono sotto le bandiere di Garibaldi, contro l'usurpatore straniero e per l'unità e l'indipendenza d'Italia.

Essi rinnovano le tradizioni dei coraggiosi deputati operai che alla Camera italiana, nel 1880, protestarono violentemente contro lo spezzettamento e l'asservimento dell'Albania.

Essi continuano la lotta eroica dei patrioti albanesi e dei soldati e dei lavoratori italiani, che, nel 1920, con le armi alla mano, hanno imposto la ritirata dall'Albania delle truppe dell'invasione italiana.

È per questo stesso ideale di libertà, d'indipendenza e di fraternità tra i popoli, che, oggi, albanesi e italiani lottano nelle Brigate Internazionali e nella Brigata Garibaldi, in particolare, contro il fascismo.

Nella mia qualità di Commissario di guerra di tutti i volontari della Libertà, io saluto gli amici albanesi che, qui e in tutti i punti del mondo, aiutano la nostra comune lotta.

Ma come italiano, come amante della libertà del mio paese, come avversario deciso della dominazione fascista sull'Albania, io saluto, in modo del tutto particolare, la fraternità d'armi stabilitasi nella Brigata Garibaldi tra italiani e albanesi.

Questa fraternità è una garanzia che l'unione nella lotta cominciata in Spagna, continuerà nei nostri paesi per liberarli per sempre dall'oppressione e dalla schiavitù fascista.

In questa speranza, che nei nostri cuori è certezza assoluta—avanti, compagni albanesi, sotto la bandiera della Libertà che i nostri eroi hanno sacro con il loro sangue più puro!

Avanti, sull'esempio del vostro e nostro compagno tenente Asim Vokshi, caduto da eroe in Spagna, nelle file della Brigata Garibaldi!

Avanti, per lo schiacciamento definitivo del fascismo e per la liberazione dei nostri paesi!

Avanti, per aprire ai nostri popoli un'avvenire di libertà e d'indipendenza, un'avvenire di pace e di benessere.

LUIGI GALLO

Commissario di guerra.
Ispektore delle Brigate Internazionali.

4-XII-1937.

E pershendes me gezim botimin e numurit te pare te Vulnetarit te Liris ne gjuhen shqipe. Kjo është një demonstratë e rritjes për herë më të madhe e të plotë që përmerr solidaritetin internacional kundër popullit spanjoll.

Nga të gjitha anet e botes—edhe nga më të voglat, edhe nga më të largat—zemrat më fisnike dhe luftetaret më trimë të Liris vrapuan në Spanjë që të mbrojnë çështjen e përbashkët të gjithë Njerezimit të mbare e të përparuar.

Edhe nga Shqipëria—e vogël në tokë por e madhe në histori për fisnikërinë e të bijvet e për luftërat e bëra kundër shkelesvet të huaj—kanë ardhur në Spanjë me dyzinë e me dyzinë luftetare që të pohojnë rishtazi me heroizmen e me gjakun e tyre dashurinë shëkullorë të popullit shqiptar për lirinë e për pamvaresinë e kombevet. Ata kanë luftuar në të gjitha brigadat. Në numër më të madh kanë luftuar në brigaden Garibaldi, krah-per-krah me vellezërit e tyre italianë.

Italiane dhe Shqiptare e kanë marrë vesh mirë që ketu nuk po bëhet lufta vetëm për çështjen spanjolle; ketu po bëhet lufta edhe kundër fashizmit italian, shtypeses së përbashkët, që Italinë e bukur e pjellore e ka ndryshuar në një vënd mjerrim dhe roberije për popullin, që Shqipërinë krenare—përmes trathetisë së Frankovet shqiptare: të Zogut dhe të renegatëve bashkëngjajtes—e ka rrezuar në një koloni italiane, në një shkallë të parë në Ballkanet për fashizmen, e cila është duke përgatitur një luftë të re.

Italiane dhe Shqiptare që po luftojnë ketu në tokën spanjolle, të bashkuar në një farë rrëshë e me një farë ideali të lirisë, përterijne traditat më të bukura të vëndëvet të tyre dhe ndjekin porosirat e poetëve dhe heronjëvet të tyre më të mëdhenj kombtare.

Ata përterijne traditat e lavduruara të 48-s dhe të epopëve garibaldiane kur shqiptaret, të frymëzuar nga poetet e tyre më të mëdhenj si Jeronim De Rada dhe Pashko Vasa Pasha, luftuan në flamurin e Garibaldit kundër usurpatorit të huaj dhe për

bashkimin e për independencën e Italisë.

Ata përterijne traditat e deputetëve punetore guximtare që në Parlamentin italian, më 1880., protestuan rreptesisht kundër copetimit dhe roberimit të Shqipërisë.

Ata vazhdojnë luftën heroike të patriotëve shqiptarë dhe të ushtarevet e të punetorevet italianë të cilët, më 1920, me armë në dorë, i kanë shtrenguar trupat e invazionit italian të hijeshin nga Shqipëria.

Është po për atë farë ideali të lirisë, të pamvaresisë e të vellezëris midis popujvet që shqiptaret dhe italianët janë duke luftuar sot në Brigadat Internacionale dhe, vëganerisht, në Brigaden Garibaldi kundër fashizmit.

Më cilësinë t'ime të Komisarit të Luftës për të gjithë vulnetaret e Lirisë i pershendes miqtë shqiptarë të cilët, ketu dhe në të gjitha viset e botes, i ndihmojnë luftës s'one së përbashkët.

Por si italian, si dashuronjes i lirisë së vëndit t'im, si kundërshtar i mospajtuarshem i zotërimit fashist mbi Shqipërinë, e pershendes në mënyrë farë të posatshme vellezërimin e armëvet të vendosura në Brigaden Garibaldi midis italianëve dhe shqiptarëve.

Ky vellezërim është një garancë që bashkimi në luftën e filluar në Spanjë do të vazhdonjë në vëndet t'ona për t'i shliëruar një herë e mirë nga shtypja dhe nga skllaveria fashiste.

Më këtë shprehje, e cila në zemrën t'one është një e vertetë absolute—përpara, shokë shqiptarë, nënë hijen e flamurit të Lirisë, që heronjtë t'anë e kanë shenjtëruar me gjakun e tyre më të dëllir!

Përpara, pas shembelës së shokut t'uaj dhe t'onit Togjerit Asim Vokshi, i cili ra hero në Spanjë, në radhën e Brigadës Garibaldi!

Përpara, që t'a dërrmojmë një herë e përgjithënjë fashizmin dhe t'i shliërojmë vëndet t'ona!

Përpara, që t'u çelim popujvet t'one një ardhmëni lirisë dhe independencë, një ardhmëni paqë dhe lumturije!

LUIGI GALLO

Komisar Luftë, Inspektori i Brigadave Internacionale.

4-XII-1937.

VJETORI I PARE I BRIGADAVET INTERNACIONALE

"Kemi vetem nje lutje te bejme: Duam te vemi ne ballin ku te jete reziku me i madhi." Keto qene fjalet e kryetarevet te batalionit te pare te vulnetarevet internacionale ketu e nje vjet te shkuar plot. Per shume muaj me radhe, qe prei fillimit te rebelionit te Frankos, njeret nga vende te ndryskem, por qe ngjau te ndadhen ne Spanje ne ate kohe e siper, vuna vulnetarisht fuqit e sherbimet e tyre ne rrjeshtat e guvernes. Engleze dhe Gjermane dhe Franceze dhe Italiane—njeret nga te gjitha kombet dhe qe rronin ne paqe a ne mergim—erdhen me deshire te vete per te sherbyer ne Ushterin Popullore te Liris. Se-pari sherbyen ne mesin e vellezervet te tyre spanjolle, duke sulmuar kazerne Montana ne Madrid, arsenalet e fortifikuar ne Barcelone, kalat e Valencies—te gjitha qendrat e fuqivet te permbledhura fashiste ne tere Spanjen. Por me vone, kur lufta qe ne shvillim e siper dhe valel fashiste flakeshin tatepjetje prej ketij muri prej mishi dhe prej shpirti te plagosur por te pamundur, te tjere njeret erdhen prej vendeve te tjere.

Shembell per kohen e ardhshme. Duke u-permbledhur ne Albacete, keta vulnetare formuan, per te paren here ne historin e botes. Brigadat Internacionale—nje ushteri e cila, sic e shprehu nje shkrimtar, "mund te trajtonje modelin per ushterit demokratike ne kohen e ardhshme." Kampet e koncentracjonit, qe ka ngrehur Hitleri, nuk ishin te forte mjaft sa te mbanin brenda luftaret gjermane, qe shihnin ne perpjekjen spanjolle nje mjet lufte kunder terorit te murrme. Asnje oqean qe te qe teper i gjere, asnje kufi qe te qe teper e veshtire per keta njeret—per keta shoke t'ane lufte.

Benjes te historis. Rrefenjat e mbrojtjes se Madridit ne ditet me te para jane treguar dhe ritreguar qindra here, dhe perseri do te tregohen shume qindra here te tjera. Per sa kohe qe njerezit qmojne lirin e tyre si njeret, per sa kohe qe drejtesia dhe e verteta dhe guximi dhe vetemohimi jene virtute ne sy te njerezis—per aqe kohe do te rronje rrefenja e Brigada-

vet Internacionale ne historin e veprave te njerezve. Porse koha per te shkruar historin akoma nuk ka arire. Mbase eshte me mire te themi qe historia e fundit e veprave t'ona ne Spanje duhet te prese gjer sa te vinje dita kur te kemi fituar ngene dhe lirin qe do te e bejne te mundur te korrim pemet e fitoret drejt se ciles po na shpijen betejat e sotme t'onat. Ne kete pike mund te kujtojme fjalet e njenga rigurat me te shkelqyera te shekullit t'one, i cili e la me nj'ane penden me pare se te mbaronte se shkruari nje nga veprat e tija me te medhate me ke-

te Alfred Brugeret, prej France; te Doktor Heilbrun, Hans Beimler, prej Gjermanije; te Guido Picellit, prej Italijs; te Bill Henry, James McCrotty dhe Liam Tullison, prej Irlandes; te Rodolfo de Armas dhe Pablo de la Torriente-Brau prej Kube; te Jack Shirai prej Japonije; te Alonso Wattson, i cili qe me i pari Negro amerikan qe ra deshmor ne Spanje; te Peter Daly, qe ra deshmor si komandar i Batalionit Engles, te Paul Block, te Daniel Hutner, te Sam Levenson, te Sidney Shostack, te gjitha Amerikane; te Blagoje Parovic, prej Jugoslavije;

s'one, nje epope te cilen ne vete do t'a kendojme dhe do t'a kujtojme kur te kete mbaruar lufta e ashpër.

Fashizma po dobesonet. Dhe qe kjo lufte po mbaron me fitimin tone, duket qarte prej sa ngjasin sot jo vetem ne Spanje por ne botten e tere. Kudo fashizma po e merr vesh tani se vrasjet e therrjet e saja me gjak te ftohte dhe agresionet qe po ben, po gjejne kunderstime. Japonija pandehte se ne nje nate e siper do te delte Fitimtare ne Kine. Por turmat Kinezet te bashkuara, i kundershuan legjionet japoneze dhe i ndaluan.



LUIGI GALLO

Komisari i Luftes dhe i Inspektori i Brigadavet mban fjalën e flamurit. Nga e djathta Komandanti e Bases, shoku Bielov.

te shpiegim te thjeshte: "Eshte me mire te shkosh permes eksperiencas se revolucionit se sa te shkruash rreth atij..."

Nder te vdekurvet. Duke festuar kete aniversar te pare te formacionit te Brigadavet Internacionale le t'u bejme nder atyre shokeve te gjitha kombeve qe kane dhene jeten ne luften t'one. Le te kujtojne vdekjen eshokut Ben Leder, aviatorit Amerikan, qe u-vra prej nje aeroplani fashist; te poetit te ri Ralph Fox, John Cornford, John Scott, shoke te ardhur prej Anglijs; te shkrimtarit Gjeneral Lukacz, prej Hungarijs;

dhe te tjere deshmoreve te parajohur.

Kur te jete mbaruar se shkruari historia e shlimrit te Spanjes prej fashizmes, keta emra dhe te shume shokeve te tjere, prej te gjitha vendeve te botes, do te jene shtyllat prej te cilave do te enden per bukuri veprat e shuma, te mbedha e te vogla, te veganta dhe te bashketa, te cilat u mbledhen tok ne nje prepjekje te madhe te rrjedhur nga thelbi i zemres se historis. Punet qe kane bere aty, dhe qe ne po vazhdojme t'i kryejme mbane, jane bere qysh tashti nje epope e madhe e kohes

Dhe tashti Japonin e ka zene frike per te ardhshmen e saj, se i beri hesapet per nje ngadhenim te shpejtte, per te vetemin ngadhenim qe ka qene i mundur per ate. Tani zoterinjt e luftes, ne Japoni, shohin se mjetet luftarake dhe ushqimore po u pakesonen, praparoja po tronditet, ekonomija po bije poshte nene shtypjen e luftes se zgjatur.

Italijs dhe Gjermanija gjithashtu e shohin fare mire qe kane kafshuar nje thele qe nuk mundet t'a kaperxjne dot. Jo vetem veshstiresit e brendshmes po shtonen dhjetefish qdo jave ne keta shtete fashiste, por edhe ndjenjat e po-

pullit, te shugatura per nje kohe te gjate, me ne fund kane nisur te shfryjne ne flage kundershimi te celur. Veprimet e reja te kryengritesvet ne Ethiopi do t'ia veshitresojne dyfish Italis te derguarit e ndihmave te medha trathetorit Franko. Dhe ekonomija e tronditur e Gjermanis eshte per kete shtet fashist nje kercnim nga prapa, sikunder eshte per Italine Abisinija e mundur por e pangadhenuar. Ç'na jep shprese me shume nga te gjitha, skena nderkombtare duket se me ne fund po ndryshon ne favorin e qeveris spanjolle legale. Franca dron te kete mundesin e nje kufiri tjeter armik ne jube; dhe si Frances ashtu edhe Anglis do t'u shteronje duri-

mi kunder pirateve te cielt u kane mbytur vaporet tregtare ne detin e Mesdheut. Opinioni popullor i pergjitheshem si ne France ashtu edhe ne Angli po rritet e po benet me i forte e me i forte çdo dite, dhe ka per t'a shtrenguar edhe diplomatin me dinak dhe me dy-pale fage te dale sheshit per anen e veteme qe ka te drejte—per qeverin legale te t Frontit popullor ne Spanje.

Kur sjellim ne mend te gjithë keta shvillime, kur degjojme demimin qe u jen Presidenti Roosevelt "gangstervet, kombevet agresore", kur degjojme se edhe ne vendet t'ona ku kemi lindur po na vijne ne ndihme, nuk mundet veg se me te vertete te jemi optimiste.

Dhe kur i bashkojme te gjitha keto ngjarje me rritjen e Ushteris Popullore te Spanjes, e cila shpejt ka per te numeruar nje million burra te armatosur fare mire, kemi edhe ca me teper shkak te gezonemi. Dhe pastaj kur shohim se perpjekjet t'ona per bashkim ketu ne token t'one te Spanjes gjithen-je sjellin peme me te medha—atehere mund te jemi te sigurte qe moti i pare i Brigadavet Internacionale ne Spanje ka mbaruar shume bukur. Ka qene me te vertete shembella jone qe i ka ngutur shume elementa te mefshte qe te shpejtojne, te punojne me veprim te plote, te kene guxim e te te dalin me fitim.

Aniversar i pare bije ne nje

kohe kur per tre muaj rrjesht ne kemi marre ofensiven ne luften kunder fashizmes. Frontet kryesore kane qene per na skena te njerit ngadhenim pas tjerit. Çdo dite qe qendrojme te patundur—t'a leme ne nj'ane perparimin, gje qe e kemi bere—na e ben fitimin me te sigurte. Eshte me kete fryme qe e mirepresim aniversarin t'one—me mburrje ne rolin qe lozim, me mirenjohje per rastin qe marrim pjese te tille ne historin e kohes sone, dhe me solidaritet kundrejt popullit spanjoll, lufta e te cilit eshte lufta e te gjithë atyreve qe e mbajne lirin te shtrenjte, dhe fitimi i fundit i te vilevet do te jete nje fitim jo vetem per Spanjen porse per tere njerezin.

BRIGADAT INTERNACIONALE

Diten e djele me 14 te muajit te kaluar Brigadat Internacionale ne Spanje festuan vjetorin e pare. Ekremtuan ne Albacete, ne qytetin ku nisen te formoneshin trumbat e saja me te para. I gjithë populli mori pjese se bashku me ushterin e tij, qe lufton ne bafin e lirise. Dita filloi me nje shfaqje ushtarake te gjithë formacioneve te bazes dhe me parakalimin e perfaqesonesvet te qeveris, te ushteris, dhe te pese brigadavet t'ona. Pasdreke ne fushen e Toros te Albacetes u-be nje shfaqje popullore ne te cilen muarren pjese perfaqesonesvet e gjithë partivet te ndryshme. Ishte me te vertete nje kremtim vella-zerimi midis popullit dhe vulnetarevet.

Pa prituri e pa kujtuar arriu ne qytetin kremtonjes PASIONARJA, tamam ne kohen e marshimit te togjevet ushtarake, te shoqerivet te rinis spanjolle, dhe te organizatavet te gravet. Pritja e bujeshme dhe spontane qe iu-be Pasionares ne çast ishte me te vertete thellesisht prekesë. I tere qyteti i Albacetes morri pjese me gezim te math ne kete demonstrate. Ky qytet i lindjes dhe i shkolles se Brigadavet internacionale qendroi te djelen ne fjale krejt nene shenjen e vjetorit te pare te formacioneve t'ona ne Spanje.

Dhe nde qofte se hedhim nje veshtrim prapa mbi vjetin e kaluar, e bejme kete gje ne nje çast kur permes vendimevet te Lidhjes se Kombevet endet perseri problema e vulnetarevet ne te gjithë

kuptimin e saj te plote. Me shume te drejte perfaqesonesvet e qeveris spanjolle kundershtojne qe vulnetaret e tyre nderkombtare, te cilet kane ardhur ketu me deshiren e tyre te lire per te luftuar ne Brigadat Internacionale krah-perkrah me Spanjollët, te kqyren me nje sy me trupat e derguara drejtperdrejt nga kumandat e larta te Italis e te Gjermanis. Ne rasen e Brigadavet Internacionale gesh-tja eshte e njerësve te cilet kane ardhur ketu me vendimin e vet per te mbrojtur lirin e demokracin e Spanjes, per te qendruar per idealin e tyre politik. Ne rasen tjeter eshte geshtja per ushterira qe me shtrengim jane transportuar aty si trupa t'invasimit. Njerezit e Brigadavet Internacionale kane ardhur aty prej te gjithë viseve te botes dhe jane vetedashes me kupetimin e vertete te fjales. Ata nuk jane nene kontrollin e qeverive tjera veg se te Spanjes. Nga ana tjeter dihet sheshit qe italianet nuk jane njerezit e Frankos porse qendrojne nen urdherin e qeveris italiane, nen kontrol te gjeneralevet italiane. Keshtu qendron puna edhe me Gjermanet e Frankos; ata nuk jane vetedashes, jane bashbozuke. Ne Spanje kemi te bejme me nje invasion te huaj dhe nuk mund te klasifikonem vulnetaret e Brigadavet Internacionale me ushterit italiane dhe gjermane te Frankos, te cilet jane derguar ne Spanje ne lidhje me imperializmen italiane dhe gjermane. Ne rrjeshtat e Brigadavet Internacionale

qendrojne biht me te mire te proletariatit te gjithë botes. Ata bijane floriri i levizjes se punetorevet internacionale. Ata jane shqiponjat malsore qe fluturojne me guxim gjer ne majat me te larta. Me gjakun e tyre ata kane forcuar frontin e popullit e te bashmit. Ata jane brezi i hekurte i ushteris popullore antifashiste ne Spanje. Las Rosas, Teruel, Pozoblanco, Jarama, Guadalajara, Brunete, Belchite, Quinto: keta vende jane deshmonesit heshtes te fuqis se madhe te Brigadavet Internacionale. Punetoret e te gjithë botes kane per t'i ruajtur si kujtime te shenjte flamuret e batalionevet te tyre kundrejt te cilevet furija e çmendur e hordhivet fashiste u-dermua. Brezat e ardheshme ndonje dite kane per t'u guditur prej veprave te ketyre shokeve t'one, vjershetaret do t'i kendojne, dhe kengetaret e popullit do t'i shpallin me lavdi.

C'eshte historia e Brigadavet Internacionale dhe si u-organizuan ne token Spanjolle? Per te deftyer kete ngjarje, le te shikojme historikisht ndodhinat qe ne fillin.

Me 18 Korrik 1936, shefet e ushteris spanjolle, trathetare kundrejt betimit te tyre, ngritne krye kunder guvernes legjitime te atdheut te vet.

Kjo kryengritje ngjau per hesap te klases se privilegjuar, e se ciles ata qene nje pjese e pashkeputur dhe qellonin te mbytnin popullin spanjoll dhe t'ia grabitnin perseri lirin e fituara disa vjet me pare.

Gjeneralet trathetare, qe e kishin ne dore aparatin e plote t'organizimit militar, besuan se do te triumfonin ne 24 ore. Porse populli i Spanje eshte i ndergjeshim. Eshte i bashkuar ne nje front popullor qe permbleth republikanet e se majtes, socialistet, komunistet, gjithashtu edhe te dyja qendrat sindikale. Per hirr te armes se bashkimit te tij, populli triumfoi ne zgjedhjet e Shkurtit, dhe trajtoi nje guverne te Frontit Popullor. Nuk lejoi te mbytet.

Kryengritjes se 120 garnizoneve te Spanjes e te Marrokut, populli spanjoll i beri nje kundersh-tim te furshem. Të zgjuar permes organizatavet te tyre, punetoret dualle ne per rugat. Guverna e Republikës i dha popullit armet, qe i perkasin. Ne kete ças u-fitua Montana e Madridit, sulmi mbi Hotelin Colon ne Barcelone, hyrja ne kazernat e Valencias. Kryengritja ushtarake u-dermua ne 24 ore pothuase se ne te gjithë token e Spanjes.

Porse nguli kembe ne njady vise te gadishullit. Populli spanjoll, i enkurajuar prej fitimevet te pare te mbedhenj, mendoi qe do t'i shtinte ne dore fare lehte edhe ato vise. Mirepo Frankoja, i cili sundonte Marrokun, kerkoi ndihma te mbedha. Bashkefajtoret e tij, te zotet e tij, Hitler dhe Mussolini, i derguan çdo gje: arme dhe vapore dhe njeres. Me kapronet italiane, me lundrat e mbrojtura prej kryqezorevet gjermane, Fran-

rrjesht ne
ne lufte
et kryeso-
na te nje-
t. Cdo dite
ur-t'a le-
a, gje qe e
itimin me
ete fryme
rsarin t'o-
a qe lozim,
n qe mar-
rin e ko-
ritet kun-
lufte e te
jithe aty-
shtrenjte,
vilevet do
vetem per
njerezin.

LE

qe e kis-
plote t'or-
n se do te
rse popul-
ergjeshim.
front po-
publikanet
komunis-
dyja qen-
te armes
ulli trium-
urtit, dhe
rontit Po-
ytet.
garnizone-
rokut, po-
kundersh-
ar permes
punetoret
Guverna e
lit armet,
as u-fitua
ulmi mbi
one, hyrja
s. Kryen-
nua ne 24
the token
njady vise
spanjoll, i
et te pare
qe do t'i
ehte edhe
oja, i cili
koi ndih-
fajtohet e
dhe Mus-
arme dhe
kapronet
mbrojtura
ne, Fran-

ja sefte solli ne Spanje legjio-
t dhe Moret. Zuri vend ne Juge.
evilla ra ne doren e tij. Keshtu
krye te atyre Afrikanëve bar-
re te terbuar, Frankoja filloi te
gjitet drejt veriut. Mola, trathe-
ri, nga Navara zbret drejt
ges.

Ne Madrid ne kete kohe populli
mer-math plot mbesim ne fiti-
n dhe lirin e tij, formon shpejt-
shpejt batalionet e miliceve vul-
tare, pa shume organizim, a dis-
pline ushtarake. Te armatosur
e fort me kurajen kreshnike
ta vetedashes u vene gjoksine
athetarevet te Spanjes.

Cfare muaj te tmershem qe ka-
gene keta muajt me te pare
kryengritjes! Ne te gjithë
ten punetoret ndiqnin me angsh-
me shpirt nder dhembe, per-
rimin e mercenarevet te Fran-
s, ne Spanje. Milicet trima te
pulli, pa pregatitje ushtarake,
lende moderne lufte, kane qe-
te shtrenguar te shprapseshin
p-per-çap perpara fashistevet.
nja e Badajozit, e shtene ne
re prej fuqive te ardhura nga
rrizi, prej kufis se Portugalis,
beri te mundur bashkimin e
nterivet rebele te Veriut e te
ges. Keto ushteri te bashkuara
rshuan tani drejt Madridit.

Forcat militare kryengritese
sponojne nje material te tmers-
h lufte dhe nje aviacion te fu-
hem te ardhur nga Italia dhe
ermania. Pake me vone rrjedhin
he ushteri prej udheve te fsheh-
Republikanet jane marre me
te prej atyreve qe duhej t'u vi-
ne ndihme. Shtetet demokra-
te, duke u-perkular perpara
rhimevet fjalembedha fashiste,
andaluan blerjen e armevet prej
veris ligjore te Spanjes. Duke
kelur keshtu te drejtat nder-
mbtare me te thjeshta, demo-
atirat e mbytnë popullin spa-
oll permes nje blokade te rende.
Qyteti i Toledos ra. Moret, Ita-
net e Gjermanet e Frankos iu-
ruan kryeqytetit. Te forcuar
ersishte me njerëse e me lenda
te, fuqit e barbaris po perpa-
ne dite-per-dite. Avionet mo-
rne te rebeleve te siguruar prej
osdenimit, bombardojne pa pus-
n grat e pleqt e femijet e krye-
tetit te Spanjes. Qe nga toka
pjetë aviatorët republikane,
aratet e pake e te vjeter te
ellevet ishin rrezuar te gjithë,
k mund vëç se te ngrinin grush-
drejt qiellit me kercnim te
dobishem. Gjithashtu edhe mili-
net, te permbysur nga bombat
topavet, te shtypur nga tanket,
deshojne vendin forcavet te or-
nizuara t'ushterive fashiste.

Ata qe e kane jetuar kete epohe
ngjike ne Madrid nuk do t'a
arrojne kurren e kurrese. Forcat

e popullit nuk mund te kundersh-
tonin me. Qene trathetuar teper
poshtersisht, te lene vetem prej
te gjitha demokrativet te botes.
Per mbrojtësit heroike qe nje gje
e lehte per te qendruar ne vend
gjer ne vdekje. Porse per pune-
torin e Europes do te qe fundi.

Atehere, ne kete dite te ngush-
te, kundrejt proletariatit te Euro-
pes kumboi zani i popullit spa-
njoll dhe i tha:

"Madridi, i cili do te bjere ne
dore te fashistevet, o shoqe, ka
per te rrembyer ne gërmadhat e
tija pas vehte te gjitha shpresat
e tua te perparimit e te liris.
Reakcioni i zi i fashizmes, duke

Punetoret e botes e muarrne vesh
qe kjo liri eshte edhe e atyreve:

"T'a shpetojne Madridin!" Ky qe
mendim i vetem i njerësvet qe, ne
fundin e Tetorit, nje mot e ca me
pare vrapuan ne token spanjolle.

Me 14 Tetor 1936 arrine ne Al-
bacete shoket e pare qe formuan
Brigaden Internacionale. Me vra-
pin me te shpejte u-derguan keta
punetore ne qendrat e ndryshme
t'ushtrimevetne te cilet u-organi-
zuan ne togje trupash te regullta,
ne batalione nderkombtare. Fran-
koja, i cili po ne kete kohe mar-
shonte me ushterit me te mira
kunder Madridit, nuk i-la te qen-
dronin atje shume kohe. Keshtu

sitare dhe me 9 Nentor ne nje
perpjekje pese oresh i flaku
fashistet pertej lumit Manzana-
res. Keshtu filloi organizimi i
madh i mbrojtjes se Madridit, para
murevet te te cilit ne rrjedhjen e
te gjithë muajvet vazhdonjes dhe
ne te gjitha perpjekjet fashistet
kane thyer koken. Nja dy dite
me vone erdhen te luftojne kra-
per-krah me shoket e batalionit
"Edgar" shoket e batalionit fran-
ces "Comune de Paris" dhe te ba-
talionit polones "Dombrowski".
Kjo qe ora e lindjes se Brigades
Intenacionale te pare, e armato-
sur vetem-e-vetem me pushka,
duke mos pasur as kasketa. Fran-



PASIONARIA, simboli i Asturive kreshnike pershendet, ne krye te delegacionit te Partis Komuniste, Brigadat Internacionale.

triumfuat ne Spanje, do te push-
tonje neses te gjitha ngastrat e
tjera te botes, atdheun t'uaj. Ju
do te shtypi pa meshire. Kjo do
te jete lufta, do te jete permby-
sja juaj, liria do te vdese!"

Ketij zeri mallengjenjes te vel-
lezervet te tyre, iu-pergjegjen
punetoret e botes: Iu-pergjegjen
punetoret vellezer te Unionit So-
vietik, qe perdoren te drejten t u
dergojne arme dhe ushqim; iu-
pergjegjen punetoret vellezer te
gjithe shteteve te botes, duke ren-
dur te radhiten ne forcat e vul-
netarevet, per te mbrojtur lirin
qe fashizma e kishte vene ne rez-
zik ne token e bukur te Spanjes.

shpiegonet fakti, qe vertet me
shume guxim ne zemer porse me
fare pake stervitje militare, bata-
lioni i pare nderkombtar "Edgar
Andre" qe me 5 Nentor e la qen-
dre ushtrimore dhe me nxitim
shkoi te marre pjese ne frontin
e Madridit.

Pesha e sulmimevet te trupave
fashiste rendonte nga ana e lumit
Manzanarës, me qellim qe te hy-
nin rebelet ne Madrid permes
Puento de los Franceses nga lagja
e Universitetit. Pese minuta para
12 u-duk, i pritur me brohorë nga
popullii Madridit, batalioni "An-
dre", i cili qe me 8 Nentor mori
pjese ne lufte ne lagjen Univer-

koja, i cili kishte mbesuar se do
te mundte te marshonte pa ndo-
nje kundërshtim te math dhe ia
pati lajmuar me radio botes ane-
mbare marrjen e Madridit, keto
dite pesoi dishfaten e pare. Kur
disa dite me vone arriu brigada e
dyte, akciet per fashistet rane
edhe me poshte. Ardhen e kesaj
Brigade kumandari i saj hero-
deshmor Gjeneral Lukasz ia beri
te njohur popullit me nje thirrje
qe mbaronte keshtu: "Kjo briga-
de do t'a mbronje qytetin t'uaj
sikur te ishte qyteti i lindjes per
cilindo vulnetar te saj. Nderi juaj
eshte nderi yne, lufta juaj eshte
lufta jone. Salud, Camaradas!"

Vulnetaret Shqiptare ne Brigadat Internacionale

Thirrjes se vellazervet spanjolle as turmat demokratike te Shqiperis nuk mundte t'i linte pa prekur. Te gjithë sjellim ndermend zine qe na pushtonte zemren kur leqitnim nder gazet reacionare te Tiranes lajmet mbi perparimin e forcave rebele drejt Madridit, renjen e te cillit fashistet e trumbetonin si te sigurte ore e cast me anen e radiovet; dhe sjellim ndermend gjithashtu gezimin t'one qe na shtonej ditadites kur kuptonim qe t'onet po beneshin me te forte edhe me te forte rreth kryeqytetit kreshnik të Spanjës.

Bashke me kushtrimin e brigades se gjeneralit Lukasz u-shoqerua edhe zeri i vogel por besnik i trumbes se vulnetarevet shqiptare. Ne vrapin e math midis punetorevet te gjithë kombevet, per te arrire ne Spanje kush-e-kush me perpara, qe t'i jepte krahun e ndihmes demokratike e liris se popullit spanjol, as shqiptaret nuk mbeten prapa. Me gjithë se prej nje populli te vogel, nje numur i math syresh ne krahasim me vulnetaret e kombesivet me te mbedhaja, arriu ne Spanjen republikane qysh ne muajt me te pare te formacioit te Brigadavet Internacionale.

Ne gjirin e grupit shqiptar te Brigadavet Internacionale ka punetore te thjeshte me zemer prej luani. Sa mendime fisnike duhet t'i kene entuziazmuar kur lane veglen e punes, me te cilen siguronin buken e perditeshme te familis se tyre, dhe me doren e tyre te forte rroken pushkat. Lirit e te drejtat e fituara prej popullit spanjoll qene vene ne rezik prej fashizmes. Po te dilte kjo ngadhenonjese ne Spanje do te dilte e ketille kudo gjetke. Atehere lirit e mija, lirit e tua, lirit e te gjithë punetorevet te botes do te qene ne rezik te gdukeshin. Ne rezik kishin per te qene jeta jone, e femijevet t'ona, e gravet, e nenvet, e motravet t'ona. Edhe nevej te tjerevet do te na ngjiste ajo qe u-ra mbi koke Spanjollevet në Badajos, në Granada, në Cordova, në Malaga e në te gjithë Jugen në fillim, dhe në Bilbao, në Guernica, në Santander, në Gijon e në te gjithë Veriun me vone. Kete rezik, kete shkaterrim nga ana e fashizmes e kane ndjere Shqiptaret me te gjithë forcen e zemres e te mendjes se tyre edhe per vete-vehten. Prane shtetevet te goditur drejt-per-se-drejt as nje popull tjeter nuk e ka koken e

tij me afer hanxharit te fashizmes se sa e ka populli shqiptar.

Te ngutur prej te ketille qellimeve te larte, kane ardhur aty ne Spanje shqiptare nga te gjitha anet dhe prej çdo shtrese te popullit: prej Shqiperis dhe prej mergimit; prej Kosoves dhe prej Cameris; punetore te thjeshte dhe intelektuale, oficere dhe njerë private qe rronin te qete ne tregtin e tyre. Reziku perpara kulgedres fashiste i beri te regetitin, te armatosen, te luftojne per shpetim. Erdhen ne Spanje, ku gjeten vatren e tyre te dyte. Ketu bene vellazerimin e tyre te vertete. Sidomos per Shqiptaret ky eshte nje vellazerim i dyfishte: midis shqiptarevet ne mes te tyre ne njerën ane, dhe midis shqiptarevet dhe shoqevet te kombevet te ndryshem ne tjetren ane. Aty qe te gjithë e ndjejne vehten shoqe e vellezer, bij te nje nene te madhe.

Shqiptaret kane marre pjese ne kete perpjekie te punetoris spanjolle kundër shtypjes fashiste qysh ne fillim te kryengritjes. Kur e themi kete sjellim ndermend ate oficerin e ri shqiptar, i cili u-vu ne plumb prej rebelevet diten e plasjes se kryengritjes. Rebelet e dinin qe zemra e Hamdiut nga Kolonja rrihte me dashuri per te miren e popullit punetor. A nuk kishte shkuar nga deshira per liri vulnetar ne ushterin franceze, ne Korçe, ne kohen e luftes se madhe, dhe pastaj kish hyre ne sherbim te ushteris spanjolle? Paten shkuar nje dite te benin ushtrime ne rrethin e Ceutes. Diten e plasjes se rebelionit e shtine ne dore Hamdine, nje tjeter shqiptar, dy shoqe bullgare, dhe bashke me disa oficere te tjere spanjolle, qe kundershuan te ngrehin kyre, i vune ne plumb. Gjaku i shqipearevet dhe i ballkanasvet dhe i punetoreve te gjithë botes u-perzje ne shoqrim te perjeteshem me ate te bijve te popullit spanjoll ne kete lufte te nxehte per liri. Te ketille deshmi dha Hamdiu, lark vendit te lindjes, lark gruas dhe nenes dhe te dy femijevet, por ne atdhe te idealit te tij, per shpetimin e te gjithë femijeve te popujvet punetore.

Ne gjurmat e ketyre deshmoreve te pare renden edhe te tjere. Te tjere deshmore ua dorezuan flamurin e liris shoqevet, qe te mos rrezonj, qe te qendronje triumfonjes mbi ate te tiranis, te forces barbare, te shkaterrimit, qe te shpetojne popujt punetore te botes nga zgjedha fashiste.

Nder te gjithë punetoret shqiptare qe erdhen vulnetare ne Spanje, dy fytyra te reja kane per shkelqyer ne perjetesi: fytyrat e shoqevet te dashur Asim Vokshit nga Gjakova dhe e Teni Konomit nga Korça. Asimi vete, e gjithë familja e Asimit, eshte personifikimi i Kosoves se martirizuar: dyfishe martirizuar. S'ishte veç se deshira per nje rrojte te ndershme dhe te lire qe e shtrengoi ate te lere token e dashur te stergjyshevet. Ne shoqerin e mijera familive te tjera shqiptare, erdhen ne vatren e ngushtuar t'onen me shprese se do te gjenin aty priten ametare te desheruar ne Shqiperin e tyre gjoja te liruar. Gjoja, secili vend i Shqiperise eshte i lire sot? Menyra si vidiq Heroi i Kosoves, Bajram Curri vete, në malet q'ish perpjekur t'i shlironte eshte nje vertetim i shemtuar qe Shqiperia "e liruar" gjendet sot nene roberi aqe te keqe sa edhe nene sundimin e huaj. Kete gjendje te keqe te vendit te tyre kujtuan, e ndjene gjer ne palce, i merguari djalosh Kosovar dhe Teni Konomi, kur qe te dy u-nisen bashke per udhen e large te fundit. U-nisen te dy shoket, Teni nga Juga dhe Asimi nga Veriu i Shqiperise per ne Spanje, per te kerkuar, si dy shtegtare trima, lirin qe deshen t'i dhuronin popullit te vet. Kjo deshira i mbajti qe te dy te bashkuar gjer ne vdekje. Kane ndihmuar me shume se kushdo tjeter nga ne qe te behet e vertete endrra tyre e bukur. I dhane njerezis ate qe kishin me te shtrenjte. Dhe populli punetor do t'u jete mirenjohes per jete.

Bashke me punetorin shqiptare, edhe djalria shqiptare nuk ka per t'i harruar kurre shoket e saj te moshes e te mendimit. Teni dhe Asimi do te jene per ate dy emra qe simbolikisht do te bejne per shqiptaret dy thirrje bashkimi. Juga dhe Veriu i Shqiperis, dini dhe feja që aqë fort na kane ndarë t'ren ne kujtimin e ketyre dy deshmoreve ne nje lutje, ne nje thirrje bashkimi kombtar.

Asimi dhe Teni qene me te mirret nder ne te gjithë, ishin floriri i kulluar i djaloris punetore shqiptare, ishin bijte shembellore te familjes punetore shqiptare. Ne perpjekjet e shoqevet te tyre kane qendruar ne balle dhe atje ku t'a kerkonte nevoja me e madhe revolucionare. Qene nga me te fortet dhe me veperimtarete militante qysh prej fillimit te regjimit fa-

qezi qe sot po ben rremuje Shqiperin. Si militante dhe demokrat revolucionare qe te dy qene flamurtare per bashkimin e popullit kunder spekulatorevet dhe perqarresvet ne vendin t'one dhe kunder penetracionit fashist italian ne Shqiperin e dashur. Teni dhe Asimi qenë—ashtu sikunder duhet te jene te gjithë bijt e Shqiperis sotshme—dy nga djemt shpirtnore te nocialistevet te moshem, si Bajram Curri dhe Themistokli Germenji, per te cile ideali i nje Shqiperije demokratike qendronte lart permby fetembesimet dhe lark influencave te huaja shkaterronjese. Si militante qe qene, ndjenja e antifashizmes, urrejtja kunder fashizmes, i çoi peshe dhe i beri te nise per ne frontin e Madridit.

Ne kete ballin e Madridit, me kete fushe lufte, ku dy forca kryesore te kunderta dhe armike jane nje perpjekjen me te madhe, fuqit vdekjes dhe te jetes, te kohes se vjeter dhe te kohes se re, te baris dhe te perparimit, te fashizmes dhe te demokratike—ne kete balle lufte per jete dhe per vdekje, Teni dhe Asimi nuk çoi vetem zemra porse edhe mendja. Ata te dy e dinin fort mire ashtu sikunder duhet t'a dije fare mire e tere djaleria shqiptare me llogjike, qe duke luftuar ne frontin e Madridit luftonet edhe ne te gjithë frontin e Shqiperis s'one. Aty po i pregatit varri fashizme italiane; e cila eshte edhe kulgedra e popullit te Shqiperis. Ky kulgedre koken e ka sot-per-se ne Spanje. Kushdo qe ndihmon shtypen kryet kesaj kulgedre ketu ndihmon qe te shpetonje edhe atdheun e vet.

Lufta e popullit spanjoll per shpetim nga fashizma eshte edhe lufta jonë per shpetimin e Shqiperis!

Dhe kur i fshijme lotet hidhur prej syvet dhe mbledhim vehten prej tronditjes nga kjo humbje rëndë, gezimi dhe mburrja pushtojne semren qe edhe Shqiperia e vogel dhe e varfer, munda krah-perkrah me Gjermanin, me Hans Beimler-it, me Anglin me Ralph Fox-it, me Italin e Picellin me Jugosllavin e Blagoye Parovitch-it, me Greqin e Kapedanem Margaritit, Peros, dhe Vernos sjelle nje therori kage te pastershlirimit te math te popujvet!

SKENDER LUARASI

LIGJERIM



Teni Kononi

Ra deshmor ne
Krye të batalio-
nit ne frontin e
Fuentes dell Ebro

Asim Vokshi

Vokshi vella!
Vokshi o shok!
Vokshi o shpirti im!
Ku je Asim,
Vella ku je?
Ku je o luftetar?
Ku je?
Ku re?
Ku? Ku?
Ku ngrite permendore
Me gjakun e kulluar
Qe Mem'e skillaveruar
Na fali o Asim!

Ku puthe dheun plot me gjak
I etur per Liri,
Vokshi vella,
Asim
O shpirt i im,
Ku ra
Yti kushttrim
Per Paq'e per Liri?

Ku ngrite grushtin me fuqi
O revolucionar!
Ku shkrove ti
Me gjakun tënd
Marshin e therorise
Këngen Djalerise?
Ku? Ku?
Asim
O shok i im!
Ku gjurma te permend?
Ku re?
Vella
Ne cilin vënd
Te vijavet te para
Ti rënd
I copetuar
Ngave duke kenduar:
"Perpara, Shoq, Perpara!"

Ah, po
Atje
Ne brigjet
E lumit Ebros re
Perdhe
Si ylli kur po digjet
Dhe zvaras o deshmor
Coptuar kraheror
Me zemerren ne dore
The:
"Shok—o
Ne Pasaremos ne!
Ja shtigjet
Per Ligjet
E ra te Njerezise!...
Perpara, perpara
Per Rojen e Liris!...

Dhe gjaku yt o Shok
Me valat eci tok
Ah gjer atje ne det
Ku Teni po te pret.
Po Teni im e Teni yt,
Qe kur ne gjak u mbyt
Te tha:
"Vella
Asim,

Vokshi o Shok i im
Më shpirtin nuk e mbunj!
Shoko, erdhem ne Spanje?
.....
Dhe vala qe u ndajti,
Dhe ligja q'u denoi,
Dhe vendi qe s'u mbajti,
Dhe gjaku q'u bashkoi,
Kendojne sot me mall
Kengen e Njerezise
Mbi gjurmen t'uaj Shoke,
Deshmore te Liris...

PETRO MARKO

LET E R

Memes sé deshmorit te liris Asim Vokshit

Nje lajm trondites: Asimin t'end
Kur e puthe çastin e ndarjes,
the: "Biro te qofte rruga e
abare! T'u-rritë ndera dhe vash-
oje rrugen t'ende pa frikë më paç
raten!..." Dhe ai, gjithenje duke
eshur, te tha: "Neno, lamtumi-
e!" Dhe iku...
E mban mend, o nena e Shokut
one, o nena jone, kur Asimi yt
uante shume, se bashke me ate
paje edhe ti, prandaj ai çqetesonej
he teper? A e mban mend kur
e vinim me Asimin t'end atje ne
atren varfanjake po te ndersh-
uen t'ende, ku ti na shikoje e
eshur dhe na ndizje zjarrin per
u ngrohur? A e mban mend kur
e flisnim me ngadale dhe ti ruaje
erjashta mos na gjurmonte ndo-

nje spiun? E mban mend se sa
e lumtur jeshje kur fliste pa
pushuar Asimi yt mbi menyren
e shpetimit nga mizerja e tiranis?
O Nena jone, Mena e shokut
t'one, Asimi yt te perkedhelte dhe
te thoshte: "Do te vije edhe dita
e jone, moj Meme!" Dhe ti i
thoshje se me pune te mbara dhe
shoke te mbare do t'ia arrijme
qellimit.
Biri yt, Asimi yt, nisi rrugen e
mbare, punoi mbare, luftoi per
mbarësin e të gjithëve sa vuanin:
Po në perpjekje e siper bijen edhe
deshmorë. Dhe në mesin t'onë
këtë radhë ra shoku ynë më i
dashuri, më i meri më trimi.
Pushka e armikut tradhtar pushka
kriminele e fashistevet, e qelloi

rendë, birin t'en, djalin e Popullit
shqiptar, Asim Vokshin.
Dhe Heroi ra siç i ka hije nje
Djali t'end, nje revolucionari po-
pullor, nje ushtari te pupullit. Ra
per Lirin t'ende, per lirin e sa e
sa mijra e miliunavet memave te
tjera — per Lirine e Memes Nje-
rezi. Ra duke thirur; "Perpara,
Shoke, se fitimi esht yne!" Dhe
kur po vertitej ne token e ndezur
te Spanjes, rembeu nje cope dhe
te pergjakur, e shtrengoi, e puthi
dhe tha: "M'i çoni lajm memes:
e kreve detyren!" Dhe heshti Asi-
mi yt, Shoku yn, Heroi i Popullit
t'one.
Dhe ne shoket e tij, djemt e
tu, po ja marrim hakun, po ja
marrin gjakun jo vetem si mbas

zakonit t'one shqiptar, por edhe
si revolucionare!
Mburru Meme dashur, se
linde nje Njeri, rrite nje Hero qe
i u - be kurban Liris se Po-
pujve. Mbaju gjithenje me trime,
se vertete humbe nje Asim, po
fitove qindra Asimer te tjere. Ata
gjakun e tyre jane gati per t'a
derdhur ne gjurmat shpetimtare
qe la Asimi yt dhe shoket e tij
qe rane ne vijat e para te Frontit
te Liris ne Spanje. Ngushello-u
permes punës së madhe të birit
tënd, të shokut t'one Asim, në
hidhërimin e kësej humbjeje të
rëndë për ty dhe për gjithë dja-
lerin shqiptare.
Tungjatjeta e qofsh me nder:
Shoket e Asimit o e sot luftojne
kunder fashizmit.

Mendime nga Fronti i Spanjes

Omeri ndenjl shesh per-balle meje mbi nje popel shkambi te dale prej tokes se kuqe, u-mbesh-tet me te dyja duart mbas push-kes, dhe heshti.

"Mos je lodhur, Omer?" e pye-ta, me shume per t'i dhene fund heshtjes merzitesse se sa nga ndo-nje kureshtje e vertete. Omerit ia kish enda te flist per-here, per-here e kishte gati ndonje mesele qe te na bente te qesh-nim. Dishka do t'i valonte ne ze-mer, odonje fatkeqesi do t'i kish-te ngjare, qe sot po heshte.

"Jo, vella i dashur" — foli duke nxjerre fjalet nga gjoksi i mbu-shur si i nje atleti dhe me syt plot zjarr — "jo, perkunder! Kur-re nuk e kam ndjere vehten kage te shendoshe dhe gati per lufte sa sot. Porse sot me benet nje vjet plot qe kurse kam ardhur ne Spanje. A me kupton? Nje vjet plot! Nje vjet lufte per lirin e popullit spanjoll — e q'them dhe une! — per lirin, per t'arten liri te popullit t'im shqiptar. A mund te ndjesh si me zemren t'ime, o vella? Memzi! Se nuk jam i zoti te shpreh mendimet e mija, nuk mund t'a perbleth dot vehten. Veg se mundet te te them kete: nje ndryshim, i math ka ngiaren vehten t'ime. E ndjenj sikur jam bere nje njeri tjetër, nje njeri i ri. Sikur nuk jam me shqiptar, dhe me gjith ate, nje shqiptar shume me i mire, me i vertete se sa kam gene me pare. Kurre nuk e kam dashur më me mall Shqiperizen t'one te vogel, kurre nuk e kam ndjere vehten te lidhur kage fort me popullin t'one te varfer shqi-petar, dhe kurre nuk kam ndjere nje dhimsuri kage te madhe per vendin t'one sa sot."

Omeri e la doren e mengjer t'i shkase prej pushkes, ngriti kryet perpjete dhe vazhdoi:

"Kam degjuar se ne Rusi rronte nje burre i mengur i urte, i cili paska thene nje here se ka mo-mente ne histori, kur minutat be-nen ore, oret dite, dhe ditet vjete. E kuptonj te verteten e ketyre fijaleve ne vehten t'ime. Jam tani dyzet vjetsh, porse ç'rendesi kane te tridhetenente vjetet ne bara-zim me kete motin e fundit te jetes s'ime? Me kete mot jam bere dyzet vjet me i motshem."

Omeri beri nje levizje dore te shkathet, thithi shpejt-e-shpejt prej pagurit te ujit, dhe pastaj vijoi:

"E mallkuara histori! Ne jeten t'one ka aqe giera te thjeshta, dite-per-dite u shkojme prane sa

mend i prekim me hunde, me gjithheate nuk i shohim, nuk i kuptojme dot. Dhe pastaj vjen nje dite e veteme lufte, nje dite e ve-teme ngadhenimi mbi vehten t'en-de, dhe nje diell i ri te shkelqen ne jete. Po. Dhe vetem permes perpjekies vjen njeriu ne diellin e ri. E ç'do te qe jeta ime pa kete vjet perpjekjeje? Ky mot lufte ne Spanje me ka çelur nje bote te re perpara dhe me duket sikur te gjithë kuptimet e mija kane marre nje brendi te re. Nje viet lufte ne radhet e popullit spanjoll do me thene per mua nje epohe e re kohe. Te gjitha vlerat e gjerta-nishme te mijat kane marre nje vlere te re; kur heth tani nje veshtrim prapa, memzi mund te rinjoh vehten t'ime."

"Omer, qenke bere filosof!" Desha te benj shaka, por e vura re ne zerin t'im qe shakaja nuk qe me vend. Per t'a shuar nesh-typjen e verejtjes s'ime pa vend kundrejt bashkatdhetarit t'im te shtrenjte, me te shpejte shtova: "Omer a nuk do te shprehesh pa-kez me qarte mbi kete pike?"

"Me gjithë qef, o shok i dashur lufte! Dhe kestu besonj se ke per-te me kuptuar me lehte. Pa shih nje here! Ti e di se une nuk jam nje revolucionar i sotshem. Ti e din aqe mire sa edhe une se sa shume gjak ka derdhur populli yn i varfer per lirin e tij qysh prej Skenderbeut dhe gjer tek Etem Totua. Qe te gjithë ne shqiptaret jemi lindur me shpate dhe me pushke ne dore. Porse gjer me tashti a kemi patur nje kuptim te plote kur kemi luftuar per lirin t'one? E kunder kujt kemi luftuar ne gjer më tashti? A nuk kemi gene te bindur se tere fajin per mjerimin t'one, per ndrydhjen t'one kombtare dhe ekonomike e kane patur disa njerë, si Sultan i Turqise, Princ Wiedi, Esad Pashe, Ahmet Zogu? Keta qenkeshin dushmanet t'one, kunder ketyre versulej zemerimi yne. Apo nuk kemi gene te bindur qe, po te vrisnim tiranin e kohes, do t'a shpetonim popullin t'one prej ke-tij mjerimi, do t'i siguronim lirin? Se ç'fare marrezi! Edhe populli spanjoll e flaku ne djall Alfonson XIII, e rrezoi Primo de Riveren, por a e fitoi dot valle lirin e vet? A nuk duallen ne shesh gjenerale te rinj qe t'a demtojne dhe t'a shtypin popullin spanjoll? Dhe si-kur te ndodhej sot ndoje trim ve-temohonjes, i cili do t'a dergonte ne ferr "Generalissimon" Franco, a beson ti se nuk do te kishte me ndonje tjetër Franco ne Span-

je? Marrezi! Regulli shoqeror, qe lindi Gjeneral Francon, çdo dite lind qindra Franco te rinj. Sa po te kesh çuar njerin ne sketerre, klika sundonjese t'a ka caktuar nje tjetër Franco, nje tjetër Zog. Nuk e ka lindur Francoja, nuk e ka lindur Zogu sistemin e shtypjes, porse perkundrazi: ky sistem Francot edhe Zoget. Apo s'esht keshtu?

"Me te vertete ashtu eshte!"

"Po, me te vertete keshtu eshte. Kushdo qe ka pese para mend e merr vesh kete te vertete! Ta-mam, ketu qendron çehstja e ne-mosur: Me eshte dashur te har-bonj i verber posht e larte tridhje-tenente vjet dhe te vinj ne Span-je, ku te luftonj nje vjet, pa te me çelen syt. Nje e vertete qe nuk ka me teper nevojë se sa per pese para mend, por qe t'a merrnja vesh m'u deshen tridhjet e nënte vjet arratisje, udhe - mbi - udhe, tridhjetenente vjet harxhim fuqi-je — qe pastaj t'i kuptonj te gjitha ne nje vjet, jo, mbase ne nje jave, ketu ne Spanje."

"Mire! E pastaj?"

"Fare thjeshte! Nde gofte se puna qendruaka keshtu, atehere te gjitha vrasjet e njerit e tjetrit, sado lart qe te qendrojne keta nje-res, te gjithë putshet politike ja-ne marëzira. Nuk duhet te qelloj-me njerezit, por duhet te qellojme sistemin. Dhe kunder nje sistemi nuk mund te luftonj njeriu me trima te veguar. Nje sistem dhe nje shoqeri perbenet prej nje turrme njerezish, prej organiza-cioni. Kunder kesaj shoqerije mund t'ë luftonj dhe mund t'ia zere vendin nje tjetër turrme nje-rezish, nje tjetër organizacion."

"Per çfare sistem po me flet, o vella Omer?"

"Per çfare sistem? Po flas per nje klase te organizuar, reaktio-nare, feudale, te pronjarevet te mbedhenj te tokevet ne Shqiperi, qe ka ne dore fushat me te buku-ra, me te mira, me te mbedha te Shqiperise, dhe ka vene ne zgje-dhe bujkun e varfer, te cilin e le-te ngordhe uriye mbi truallin e vet. Flas per nje klase pronjaresh te mbedhenj tokash, e cila, qe te qendro nje e zonja e tokes, zbaton fuqin e saj permbi popullin me çdo mjet tmerri. Flas per nje klase pronjaresh te mbedhenj toke, e cila, per te qendruar ve te ne fuqi, eshte gati t'ia fale Shqiperin edhe dregit. Flas per mbi fuqin e nje grushti njerezish të shitur, te deg-jeneruar, mizerabel, te cilet e qua-jné vehten shqiptarë, kur eshte geshtja te mbrojne pronjat e tyre

te mbedha tokash dhe fuqin e tyre prej popullit te uretuar. Ky grush-hajdutesh te majmur duhet te qe-lonet dhe te rrezonet. Dhe atehere permysen vetiu edhe Zoget. Keta nuk jane shqiptare. Keta nuk kane asgje te bashket me popullin shqiptar. Per keta eshte nje so-le se permbi cilin popull sundojne Qellimi i tyre eshte vetem t'i shtypin dhe t'a rrjepin per fitimin e tyre.

Omeri thithi perseri prej pagu-rit te tij dhe vazhdoi:

"Ata nuk jane vetem shushunja e popullit shqiptar: ata jane me-teper. Per te siguruar sistemin e tyre tregtar dhe rrjepes, jane shtrenguar te lene prapa te gjithe shvillimin ekonomik dhe kul-tural te popullit shqiptar. Pasa kete nuk mund t'a bejne dot me fuqit e veta, jane te shtrengua t'ia shesin Shqiperin Italise — fas-hizmes italiane — e cila u jep kra-he. Domosdo jo per shpirt te ba-bait! Fashizma italiane si shper-blum merr pjesen e luanit prej len-gut te jetes se popullit shqiptar. Veg kesaj Italijs e ben Shqiperi-treg per te shitur prodhimet e in-dustris italiane. Kjo gje e pengon shvillimin e çdo industrie; e çdo lartesimi ekonomik te vendit. Dhe nje popull i dobet, i pashvilluar ekonomikisht, eshte i detyruar nene shvillimin e sotshem te shte-tevet te mbedhenj — dhe te fashiz-mes — t'i benet kurban fashizmit. Apo nuk e kemi vene re kete gj-ne Abisinin? Apo nuk e veme ne edhe sot ne shembellen spanjolle? Spanja eshte nje toke e pashvil-luar industrialisht. Pjesa me ma-dhe e dheravet gjendej ne dore e pronjarevet te mbedhenj tokash prej mesit te cilevet u-rekrutua-soldateska spanjolle. Fashizmi italiane dhe gjermane duan te perdorin kete vend si fushe eka-ploatimi dhe tregtije. Keshtu ngacmuan gjeneralet trathetar-kunder popullit. Dhe sikur mundnin gjeneralet te dilnin fitim-tare, atehere edhe Spanja do v-inte nene sundimin e Italise, si kurse Abisinija. A munda shpiegonem?"

"Fare qarte", i thashe me pra-nim per sa tha.

"Po", vijoi Omeri bisedimti "cilido vend i pashvilluar ekon-omikisht patjetër sot duhet te bje-re ne thonjt e fashizmes. Edhe kjo eshte nje e vertete qe nuk ly-me teper se sa pese para men-per t'a marre vesh, por edhe ke-te vertete per t'a kuptuar na v-desh te vinim gjer ne Spanje."

"Domethene qe paskemi mba-

ruar fare, posa qenka ashtu", thashe me ze te shtypur.

"Jo!" u-pergjëgj Omeri, pothua se me kercnim. "Qeshta nuk qendron domosdo keshtu! E theksonj fjalen "domosdo". Abisinija u-mund, Spanja nuk do te mundet. Porse edhe sikur te mundej ne kete cast, do te qe vetem nje dishfate e perkoheshme, e ka-luarshme. Ngase keshtu? Dukej sheshit se ketu ka per te marre fund puna permes ketyre momen-teve: Ne Spanje shtresat demo-kratike te popullsis, punetoret bujqet dhe shtresa e mesme qyte-tare, e kane kuptuar qe vetem po te jene te bashkuar, te organizuar mire, te lidhur tok, mund t'a shuajne fashizmen e brendesheme dhe te mbronjen prej asaj se jasht-mes. Perandaj, jo putshet, o mik i dashur, porse turmat e organi-zuara te popullit duhet t'i qen-drojne per balle armikut te jashtem dhe fashizmes. Nje tur-rme e bashkuar dhe e organizuar, e cila di se perse benet lufta, dhe qe udhehiqet drejt e njesh! Dhe permby keto te gjitha: duhet nje kuptim i qarte i politikës se jasht-me, nje lidhje e drejte me popujt demokratike, nje bashkëmarshim i vertete, nje bashkëluftim me shtetet demokratike."

"Vertet ashtu, Omer!" mendova une. "Atehere pra politika jone eshte e drejte: me Jugosllavin kunder Italis! Jugosllavia do te na shlirojnë."

"Jo, kjo eshte e gabuar. Per-kunder, kjo politike eshte nje shembell se si populli yne shqipe-tar demokratik nuk duhet t'i zgjedhe shoket e politikës. Ajo qe kerkonj une permby te gjitha esh-te vetembesimi, mbesimi ne fuqit e veta, ne punen e vet. Jo me te ndenjor ne kafe dhe atje me te biseduar se kush do te na "shpe-tonje", a valle Jugosllavia apo nje tjeter qeveri — Na vete duhet t'a organizojme dhe t'a pregatitim shliroimin t'one. Te gjitha shtresat sundonjese dhe guvernat e shtet-ve t'one fqinj ose jane reakcio-nare ose fashiste. Dhe prej ke-tyre nuk dohet t'a presim shli-rimin t'one. Ata jane imperialis-te dhe duan te shpetojme nga zgje-dha e fashizmes italiane vetem qe te na shtijen ata pastaj ne zgjedhen e imperializmes se tyre. Shlirimi i Shqiperis eshte pune e popullit shqiptar! Porse nuk duhet te harrojmë qe, se-pari esh-te detyra jone te luftojme bashke me cilindo popull, me cilindo shtet, qe me te vertete lufton kunder fashizmes; dhe se-dyti qe ne shte-tet e Ballkanit dhe ne Itali ka popuj, qe luftojne jo vetem kunder fashizmes por edhe kunder rober-imit te tyre per te drejten e vete-vendimit. Keta popuj jane Maqe-

dhonët, Kroatet, Slovenet, Monte-negrinet, Gjermanet e Tirolit te Juges, e te tjere. Keta jane velle-zerit e natyreshem t'onet. Keta popuj mund te benen te lidhurit ne bese, me keta duhet te mars-honje populli shqiptar: Veç ke-saj ne Itali, ne Serbi, ne Bulgari

"Posi nuk paskam te drejte. Ke-te m'a ka mesuar Spanja. Per-mby te gjitha: Vetembesim, vete-punim, dhe pastaj nje zgjedhje te drejte shokesh lufte. Shqiperija jone e bukur dhe e dashur ka mbe-tur prapa e paorganizuar politi-kisht dhe ekonomikisht. Por ka



General MIAJA

dhe ne Greqi ka shtresa te gjera demokratike bujqsh dhe puneto-resh qe po perpiqen te sigurojne shliroimin e tyre politik dhe eko-nomik. Lufta jone per shliroim du-het te endet paralel dhe krah-per-krah me keto luftra. Keta jane shoket t'one te vertete lufte dhe jo qeverit e tyre.

"Besonj se ke te drejte, i das-hur Omer."

nje djaleri madheshtore, e cila ka provu ar ketu ne Spanje, mes per-fagesonjesvet te saj, se sa eshte e zonja te benje pune. Por duhet te largonet prej politikës se vje-ter putshiste, e cila vetem kurba-ne lyp por asnje fitim s'na sjell, dhe t'i pervishet punes se vertete. Sot ne Shqiperi, cilido qe organi-zon nje ode kendimi per bujqet, një shoqeri bujqesore, nje kasë kursi-

mi pas sistemit Reiffeisen, nje shoqeri muzikore, nje fushe spor-tive per te rinjt, eshte nje hero me i math nga ay qe ne menyre romantike do te vriste Ahmet Zo-gun. Lark qofshin lodrat roman-tike te putsheve dhe rrofte puna e vertete e vogel e organizuar e cila i ndihmon popullit t'one te bashkonet, te lidhet ne nje front te njejte, dhe e larteson kultural-isht dhe ekonomikisht. Vetem ke-shtu mund te pregatitet shlirimi yne politik."

"Do me thene, nje permbledhje e te gjitha fuqivet."

"Fare drejt! Nje permbledhje e fuqivet demokratike te popullit shqiptar. Nje permbledhje e të gjithë fuqivet demokratike ne Shqi-peri, te cilat duan me te ver-tete te luftojne kunder roberimit te turpshem ekonomik dhe poli-tik te popullit shqiptar permes nje qete pronjaresh feudale te mbedhenj tokash, ne kryen e te cilevet qendron Ahmet Zogu. Nje permbledhje e të gjitha fuqivet demokratike te popullit shqiptar, te cilat duan t'a shlirojnë atdhene t'one madheshtor nga cdo sundim fashist i huaj. Nje permbledhje e te gjitha atyre fuqive te popullit te sklaveruar shqiptar, te cilat jane gati te punojne dhe te vdesin per lirin e tij. Ne kete mes nuk pyesim as per fisin as per drejti-min politik, as per mbesim e fe. Ne luftojme per shliroimin eko-nomik dhe politik te popullit shqipe-tar, per bashkimin dhe per pam-varesin e tij, per naltësimin kul-tural dhe ekonomik te tij kunder reaksionit dhe kunder fashizmes dhe cilido qe na ndihmon ne kete qellim eshte shoku yne i mire-pritur lufte.

"Keshtu eshte i dashur Omer!" Sa s'munda te permanj vehten t'ime qe ta perqafonja.

"Po keshtu eshte dhe fuqia jone zulmonjese ka për te qene djallria jone shqiptare e forte dhe vete-mohonjese, e cila me te vertete e dashuron popullin t'one theror dhe ka mbesim te patundur ne ndertimin dhe ne nje te pritme me te mire te vendit t'one madheshtor. Domosdo kjo eshte e mundur ve-tem ate here kur fashizma te jete permbysur ne tere boten. Prandaj luftojme ne kunder fashizmes ne qdo ball te lufte qe te na jepet rasti. Popujt e shtypur te Ballka-nit dhe t'Evropes qendrore kane pert e qene shoket t'ane me t'afertë lufte dhe ne Shqiptaret t'atyre-ve. Keshtu do te dalim se bashku ngadhenonjes!"

Omeri u-ngrit me te shpejte me kembe, beri nje levizje te shkat-het dore, duke treguar frontin e lufte, dhe ne u-nisem pas atij.

DEMIR GURA

Njezet - Vjetori i

Njezet vjet te Bashkimit Sovietik—kjo do methene nje ngadhnim i veprimtaris njerezore, i perpjekjes dhe i energjis njerezore si edhe nje hov i genis njerezore mbi pengesat dhe veshtiresirat e panumurta.

Ka tashti njezet vjet qe kurse punetoret dhe katundaret e perandoris se vjeter tsariste, nen drejtimin e partis se bolshevikevet te Leninit dhe Stalinit, fituan pushtetin duke vendosur Shtetin Sovietik. Dhe jo vetem reaktionaret e tere visevet por edhe vet ata demokratet me te ndritur dhe politikane te njohur lajmeronin si profete qe kjo "eksperience" do te falimentonte. Ata verenin veshtiresirat gjiganteske; nje vend krejtesisht i rrenuar nga sundimi gjakatar i tsarit, nga pazotesia e Kerenskit, nga lufta e madhe dhe nga lufta civile, nga varferia, nga mizeria, injoranca, burokratia, nga fuqia e sundon-



Litvinov

jesvet, nga mensheviket, socialist-revolucionaret e tj.

Keta profeter shikonin keto pengesa, por te verbuar nuk verenin: fuqin e jashtezakoneshme zgjimin e klases punetore, te katundarevet, te partis se bolshevikevet, madherin e njerezvet si Lenin dhe Stalin.

Me te vertete nje perpjekje gjiganteske: kundra armevet te Koltchakut, te Dekininit, te Wrangjelit, te Judenitchit. Luftet kundra armatavevet te nje duzine nga fuqit e huaja. Luftet kundra kapitalismit te dukur nen nje mije maska dhe qe nuk deshte te kuptonte rrenimin e vdekjen e tij. Mobilizoi tere agjentet e vet dhe i versuli kundra regjimit sovietik: socialist-revolucionaret, mencheviket, "partin industriale", kulaket, spiunet, trokistet. Rekrutoi nje armate te perbere prej krimineleve, kusarevet, spiunevet, sabotatorevet, agjentevet te mshehte me qellim rrezimi te regjimit sovietik.

Te gjitha qene te kota. Bashkimi Sovietik eshte ne kembe, i madh, i pakufishem, solid, Socializmi deperton kudo dita dites triumfator. Bashkimi sovietik ndrit ne naten e erret te fashizmit, ne naten e barb arizmes dhe te regjimit gjakatar fashist. Eshte feneri i njerezise, shpresa, ungjilli dhe kurani i tere njerezimit te shtypur te dheut.

Vetem me njezet vjet socializmi

ka ndryshuar krejt faqen e visevet qe perbejne nje te gjashten e dheut. Shkretira, steppe te ngrira, u bene me qytete te ndritur. Vende te lena u bene kolkhoze te lulezuar. Atje ku me pare vajtonte qyqja tani nje jet' e re nje kenge e re ndihet. Atje ku me perpara varferia erresonte mendjen dhe zemren, tani nje jete e re krijonjese qarkullon. Atje ku me pare mbreteronte injoranca tani triumfon aresimi. Atje ku me perpara uria vashdonte tani teperrica e madhe shtohet. Atje ku me pare sundonte barbaria, tani ushton kenga e punes, e gezimit e krijimit.

Socializmi shduki urin nga miliona njerezish. Shduki mizerjen nga te shtreket punetore. Krijoi qytet te reja, industrin e re, gjet burime te tjera jetese dhe pasurimi, ndreqi hekurudhen neper shkretetira, krijoi Universitete, shkolla, Akad e mira dhe institute shkencore, shpuri driten elektrike ne katundet me te largeta, hapi teatra, muzeume, biblioteka, sanatoriume — te gjitha per puntorin, te gjitha per ata qe prodhojne, te gjitha per popullin. Duzina kombesh e kombesirash, te shtypur dhe t'eksploatuar prej sundimtarevet tsariste u liruan, ngriten kryet e tyre, gjeten jeten e tyre autonome dhe sot marrin pjese ne nje Bashkim te ndershem, qe me popujt e tjere perbejne nje komunitet: Bashkimin vellazeror



NE FRYMEN E LENINIT

e nen drejtimin e Stalinit Sovietet po e ndryshojne nje te gjashten e dheut.

Bashkimit Sovietik

te republikavet socialiste sovietike.

Qytete ndrojne pamje, katunde ndrojne pamje, njerezit ndrojne jeten dhe ujjat ndrojne drejtimet — te gjitha ndrojne nga dora punetore, krijonjese e socializmit, e marxism-leninismit, nen drejtimin e partis se bolshevikevet, nen udheheqjen e shokut Stalin.

Fashizmi qe mbreteron permbymale kufomash, qdo dite terrorizon popujt te qete — Abisinin, Spanjen, Kinen — dhe eshte gati te ndez flamen e shkaterrimit ne tere boten, fashizmi qe me plumb e me litar ndjek bijt e vertete te klases punetore, kuxon te luftoje edhe truallin e socializmit duke derguar spiune e tradhetore me qellim qe te provokojne Bashkimin Sovietik. Me kot! Roja e socializmit, Bashkimi Sovietik vashdon qetesisht dhe madherisht rrugen e vet, rrugen e paqes, e liris, e perparimit socialist.

Trotsky, i cili gjithenje ndoqi nje lufte kundra partis se bolshevikevet dhe Leninit, nuk heshti as edhe pas triumfit te revolucionit, por vashdoi te hedhi mshehura dhe haptazi faren e perçarjes kundra partis komuniste. Ai kerkon te rivendosi kapitalizmin. Ishte kundra industrializimit te vendit. Dhe ne rast se turmat kishin ndjekur "keshillen" e tij, Bashkimi Sovietik do t'ishte nje vend i varfer ekonomikerisht dhe sot do t'ishte nje fushe e kollo-

jeshme per invasoret e huaj. Ai mbeshetetej ne reformen kolektive te bujqesis. Duke perdorur frazasi "radikal" mbronte nje politike qe do te shpinte revolucionin ne gremine. Ne gjurmat shkaterronjese qe ndoqi arrijti nje dite te hyje ne sherbimin e fashizmit hitlerian. Nen sherbimin e ketij te fundit ky organizoi atentate kundra drejtonjesvet te qeveris sovietike dhe te partis komuniste. Dhe agjentet e tij nen nje "akord vellazeror" bashkepunojne me spiunet fashiste gjerman dhe spanjolle. Fashizmi dhe trotskismi — qe te dy jane betuar te shkatrojne Shtetin e punetorevet dhe te katundarevet. Trotskistet dhe bukharinistet me nje qellin te perbashket bejne q'eshte e mendur per te dobesuar Bashkimin sovietik dhe per te mbjellur faren e tyre. Por qdo tentative e tyre falimenton nga veshgimi i turmavet sovietike, nga fuqia e pa thyer e regjimit sovietik dhe nga fuqia e tij drejtonjese: Partia komuniste.

Por disa kryetare reaksionare te social-demokratise veprojne po ashtu me qdo mjet per te demtuar Bashkimin sovietik. Me kot! Tere turmat e shtypura te botes mbare dine qe Bashkimi Sovietik eshte atdheu i tyre, e ardhmja e tyre, mbesheteteja e tyre dhe garancia e triumfit te fitimit te tyre, burimi i tyre i fuqis, i kurajos, i heroizmit.

Njezet vjet te Bashkimit Sovietik — e pamundur te shpiegohen, e pa mundur te ziren me goje ne nje vend kaq te shkurter per terimet dhe ngadhnimet kollosale te socializmit. Po te filloje njeriu dhe te permendi: organizimin shtetnor, Koshtituten, jeten e punetorevet dhe ketundarevet, kolkhozet, ligjet elektorale, armaten e kuqe, industrin e rende, industrin e tjera, industrin e ushqimevet, partin komuniste, sindikatat, institucionet arsimore per turmat, bibliotekat, theatrat, cinemat, muzet, klubet, djalerin, femit, grat, siper-marrjet gjiganteske te Bashkimit sovietik—nje jete e re, nje Bot'e re plot gjalleri qe vashdon rrugen e ndritur per lumturin e popujve te dheut.



Dimitrov



Ndertonjesit e Socializmit kqyrin planin ppevjetshorjt te trele.

Ayuntamiento de Madrid

MARSHIMI I FITORES!

Popujt e Sovietit e kremtuan madherisht njezetvjetorin e Revolucionit socialist shpetim mtar dhe kurre me pare nuk kane qene pervjetoret e tjere ne te tille mase me te vertete festa popullore. Njezet vjetori i Unionit Sovietik socialistik qe dita e triumfit te popullit te math vella ne Lindjen e Europes mbi te gjithë boten e vjeter! Idyti plan i math pesevjetshor, ne plotesim e siper, qe u sjell popujvet pasuri, e lumturi, dhe konstituta staliniste, nje forme e demokratike me se gjere e panjohur gjer tashti, qe u sjell popujvet dhe racavet lirin e Socializmes, gjeten milione ushtime ne demonstracionin e popujvet te kesaj dite. Ne prapun e dhjetorit te trete te Unionit Sovietik dhe brenda ne luftat fashiste kunder Spanjes s'one dhe kunder popullit kines, njezet vjetori qe nje thirrje madhestore te gjithë popujvet te dheut: Drejt ruges se Unionit Sovietik per mbrojtjen e paqes dhe te pamvaresise se popujvet!

★

Unioni Sovietik eshte Toka e Socializmes ngadhenimtare, Atdheu i te gjithë punetorevet, Drita udherrefenjese e liris se gjithë popujvet te shtypur.

★

Unioni Sovietik eshte Miku i patriotit i popujvet luftonjes te Spanjes dhe te Kines, Mbrojtja e te gjithë vendeve te kercnuar prej fashizmes.

★

Unioni Sovietik eshte keshtjella e madheshtore e paqes se pandare, e demokratike se popujvet, e perparimit dhe e Socializmes se botes.

★

Mbrojtja e Unionit Sovietik eshte prandaj detyra e te gjithë antifashistevet, e te gjithë popujvet, dhe e te gjithë Njerezis perparimtare!



USHTERIA E TRIUNFIT!

Festimet ngadhenimtare Njezet vjetorit te Unionit Sovietik u-kurorozuan me marshimin madheshtor te Ushterise se Kuqe ne Sheshin e Kuq te Moskes, ku qene derguar delegacione nga te gjithë unitetet e tokes, te erez e te flotës: nje demonstracion i pushteshem i fuqis dhe i vulnetit te paqes te nje populli 170.000.000. Per nderin e Popullit Spanjoll luftonjes festimet e simvjetme te Nentorit u-pershendetne pas marshit "Internacionalja" me hymnin e Republikes Spanjolle, dhe Kuman-danti me i Larti i Ushterise se Kuqe, Marshal Woroshilov iu-pergjegj pershendetjes se Ministrise te Mbrojtjes te qeverise spanjolle te frontit popullor, Prieto, perpara tere popullit sovietik dhe ushterise se tij: Ushtaret t'one, punetoret dhe bujqt luftojne vel azerisht me ju gjer ne rifitim e pamvaresise se vendit t'uaj, permes ngadhenimit kunder rebellevet fashiste dhe invadorevet!

★

Ushteria e Kuqe e U. R. S. S. eshte mbeshtetja me e fuqishmeja per mbrojtjen e paqes se popujvet dhe te vellazerimit te popujvet.

★

Ushteria e Kuqe eshte vellai i fuqishem armesh i popujvet luftonjes per lirin e tyre te rezikuar nga lufteshpallesit fashiste.

★

Ushteria e Kuqe eshte keshtjella ma e fuqishmeja e demokratike se botes dhe e Antifashizmes internacionale.

★

"Perandaj Unioni Sovietik eshte Paraluftetari i drejtesise internacionale, i pamvaresise dhe liris se gjithë popujvet".—(Negrin.)

Ayuntamiento de Madrid

SPANJA KREMTON U. R. S. S.

Njezet Vjet mpranije e Liris, e Pages dhe e Mbaresis. Kurse popujt e Spanjes po qendrojnë në një luftë gjigande për lirin dhe pamvarësin e atdheut të tyre, i cili është sulmuar pabesisht prej fashizmes internacionale, popujt e Unionit të Republikave Socialiste të Sovjetike po mbushin njezetvjetorin e Revolucionit të Math Proletar, ditën e vjetit të shpirtit të tyre me rendesi historike botnore, që çeli portat Socializmes.

Spanja e Popullit, Spanja e Liris dhe e Mbaresis e kremton këtë ditë si një festë të veten, aqë e madhe është lidhja e popullit spanjoll me popujt e Unionit Sovjetik. Se populli spanjoll shenon me popujt e Unionit Sovjetik me shumë se sa pushtetin miqësor, i cili në këtë kohë të vështirë të luftës qendron në anën e Republikës Spanjolle. Popujt e Spanjes e dijne, që kanë në Unionin Sovjetik një mik shpirtmath. I cili nuk kërkon asgjë për vehtë, as pasurim toke, as shtimin e fuqisë politike, dhe që pamvarësisht nga të gjitha tronditjet ose ndryshimet e politikës internacionale, e ka bërë e patundur ceshtjen e popullit spanjoll ceshtë të veten. Unioni Sovjetik është, po, mbrojtësi i fuqishëm i Liris, i perparimit njerezor dhe i të drejtave të tyre popujve, të cilët fashizmi akmitare i ka zgjedhur si preje të rremujes së saj. Në mes të gjymirimit të kanoneve dhe të plasjes së bombave, në mes të këtij deti prej vajtjesh, loti, e gjaku, që kanë sjelle mbi krye të Spanjes shkaktohet e mallkuar fashiste të kësaj lufte, ndodhja e Fuqisë së madhe Sovietike është për popullin spanjoll një burim i forës së re dhe guximit të ri që përpiqen e tij heroike për të ruajtur lirin e vet, lirin dhe paqen e të gjithë popujve, t'a vazhdonjë gjër në fitimin e mbare të saj.

Si do të dukej bota sot, sikur njezet vjet me parë bujqë e punëtorët e Unionit Sovjetik nën udhëheqjen e partis lavdiplote të bolshevikeve të mos e kishin fituar luftën kundër reacionit, kundër armiqve, kundër kapitalizmit dhe pronjareve të mbedhenj feudalë të tokave? Si do të dukej bota sot, sikur popujt, që banojnë në të gjashtën e dheut, nën udhëheqjen gjeniale të Leninit dhe Stalinit të mos e kishin themeluar Socializmin dhe të mos kishin realizuar Demokartin me të mbajtur të botes? Pa qenjen e Unionit

Sovjetik sot Spanja do të që bëre koloni e Hitlerit dhe e Mussolinit, bashkë me Cekoslovakinë e shumë vende të tjera. Pa qenjen e Unionit Sovjetik njerezia do të që shkaktohet prej flagëve të përvlonjesë të shkaktohet prej fashistëve të luftës.

Mjafton të bëjmë këtë pyetje dhe mund të kuptojmë përnjehershë se sa rendesi të madhe ka qenja e Unionit Sovjetik për jetën e popujve, për të gjithë njerezin paqëndrueshëm. Në të këtillat rrethana nuk është e mundur që popujt e Spanjes e duan token e madhe të Socializmit sikur se lirin e tyre.

Revolucioni i math Proletar ka për popullin spanjoll një rendesi shumë më të madhe se sa është thënë gjër tashti. Ndodhë karakteri i revolucionit popullor spanjoll, që është i lidhur pandaresisht me këtë luftë, është thellësisht i ndryshëm prej karakterit të Revolucionit të Tetorit 1917, gjene punëtorët dhe bujqë ruse i kanë dhënë popullit spanjoll përmes revolucionit të tyre një sërë mesimesh jetike, pa zbatimin e të cilëve Republika spanjolle nuk do të kishte qenë e zonja t'u bente balle sulmave të fuqive fashiste invazionese dhe t'a fitonjë luftën kundër fashizmit internacionale.

Në radhë të parë kujtojmë shembellën e kundërshtimit heroik të punëtorëve dhe të bujqve të Rusisë kundër ushtërimit imperialist të intervencionit, të cilat rrodhën në tokë nga të gjitha anët. Qëndrimi lavdimath i punëtorëve dhe bujqve të Rusisë, të urishëm, të sveshur e të xbatshur e t'armatosur keq, kundër ushtërive shumë here më të mëdha në katërmbëdhjetë fronte, ky qëndrim, i cili me krijimin e Ushtërimit të Kuq me në fund në Vjeshtë 1919 u-shvillua në një luftë sulmonjese fitimplotë, i dha popullit spanjoll guximin dhe fuqinë t'i ndalonjë ushtërit invadonjese të shtetëve fashiste. Kjo shembell na ka dhënë mesimin që për të dale mundes është nevojë për një ushtëri të drejtuar dhe të urdheruar nga një komandë e lartë, e një ushtërie të tillë që është e rrenjosur thellësisht në vulnetin revolucionar të masave punëtorë të popullit. Të paharruara do të mbejnë ditat e para të Nëntorit 1936, në të cilat u-organizua mbrojtja e Madridit me parolën: "Petrograd 1919-Madrid 1936." Kujtimi mbi dishfaten e Judenitsht para Petro-

gradit u dha mbrojtësve lavdiplote të Madridit guximin dhe vetëmbesimin, që t'a benin të vertete atë që dukej e pamundur dhe, përkundrazi klithmave të shprehshme të defaitistëve, t'a shpëtonin Madridin.

Një tjetër mesim themelor, që i dha revolucionit rus frontit popullor të Spanjes, është ky; që kushti për të dale me fitin të plotë është lidhja dhe bashkimi i punëtorëve dhe i bujqve. Ky bashkim në të dhjetë muajt e parë të luftës në Spanjë është vënë në rezik të math dëndur prej elementëve të të fshehtë "të pakontrollueshëm" dhe prej komiteve. Porse me kohë edhe ky mesim i Revolucionit rus u-bë prapë e përgjithëshme e tërë sektoreve të frontit popullor antifashist; dhe bujqë argatë, që kanë marrë token prej frontit popullor, janë të lidhur besnikisht me punëtorët në luftën kundër fashizmit.

Unioni Sovjetik ka çelur një fletë të re në historinë e politikës së kombsirave. Ay i ka detyrë botes se 150 popuj mundet të jetojnë tokë vëllazërisht pa qenë nevoja që njëri komb të shtypë të tjerët, t'i mbanjë poshtë politikisht dhe ekonomikisht, t'u cduke gjuhen dhe traditat e kultures së tyre, dhe t'i fyenjë në ndjenjat e tyre kombtare. Ky mesim është më rendesi të madhe për popujt e Spanjes dhe posacerisht për Katalonjen, se ciles përmes kesaj shembelle i është treguar se mund të rronjë në lidhje vëllazërore me popullin kastilian dhe me popujt e tjere të Spanjes, dhe prapë-se-prapë t'i gëzonjë të drejtat dhe lirin e saja kombtare në masë të plotë. Nde qoftë se sot populli spanjoll dhe populli katalan në lidhje të pashkeputur e vazhdojnë luftën e shpirtit kundër fashizmit internacionale, kjo rrefen se shembella staliniste e politikës së kombsirave të Unionit Sovjetik ka ndihmuar në masë të madhe drejt këtij vëllazërimi. Me qindra janë mesimet, që i ka dhënë Revolucionit i Math Proletar popullit spanjoll për luftën e tij, dhe jënë pranuar jo vetëm prej klases revolucionare të punëtorëve, por edhe prej qytetarit të vogël republikanë, prej të gjithë popullit antifashist. Qoftë për institucionin e komisarit të Luftës, për organizimin e Produktionit, për Luftën kundër Spionazhit fashist ose për ngrehjen e kultures, për të gjitha popullit spanjoll, pa qenë aspake ne-

vojë të ignoronjë vecorirat kombtare të luftës së tij dhe karakterin e ndryshëm të revolucionit të tij, mundet të nxerë shumë prej eksperiencave të punëtorëve dhe bujqve ruse, të popujve të shliaruar të tokës së madhe sovjetike. Do të largonëshim fort, sikur të rrjeshta në aty mesimet e panumurte, që i ndihmojnë popullit spanjoll sot të fitonjë luftën kundër fashizmit internacionale. Porse një mesim më rendesi të përmuarshme duket të theksohet vëcanërisht:

Pushteti Sovjetik dhe partia bolshevikë nën udhëheqjen e Stalinit i kanë bërë një shërbim të math shumë popullit spanjoll dhe Republikës spanjolle përmes zbulimit të kohës të Trozkizmit si një agjunkturë kriminale të luftës pallesve fashiste. Pa këtë zbulim të kohës, mundet ndofta të kishte ngjarë ashtu, që agjentët trozkistë të Hitlerit, të Mussolinit dhe të Francos t'a kishin goditur prapë kurrrizit luftën shpirtore të popullit spanjoll dhe t'a kishin arritur asaj pune, që nuk mund t'a arrinin dot vetë Francoja me të gjithë divisionet italiane dhe gjermane të tij. Që ky mesim mjerisht nuk u-mesua me kohë nga të gjithë sektoret e frontit popullor antifashist në të tërë rendesin e tij, i ka sjelle dëm të pamaturshme ceshtjes së Spanjes antifashiste. Roll'i cfameshëm, që po luan trozkizmi në Spanjë, jo vetëm që provon të drejtën e konstantimeve staliniste përmbi Trozkizmin, porse edhe u ka çelur sytë shumë vetave, që me parë nga mendje-ngushtesia e tyre i kishin mbyllur sytë vetë përpara faktetë të zbuluar në gjiqet e perseritur të spionazhit në Moske.

Zemra e madhe e popullit spanjoll rrefi me zjarr për token madhështore, shpirtin e se ciles njezet vjet me parë është ngjarja me e rendessishme në historinë e njerezis. Populli spanjoll e di fare mire që ndihma edhe miqësia e Unionit Sovjetik është altruistike dhe nuk rrëthet nga asnjë tjetër motive vec që nga fakti, të cilin Stalini e ka shprehur në mënyrë kage të qartë:

"Shpirti i Spanjes prej rremujes së reacionit fashist nuk është një ceshtë private e Spanjoleve, porse është ceshtë e përgjithëshme e tërë njerezis përparimtare."

"LA LLIBERTAT"

LUFTA NE SPANJE DHE PAMVARESIA SHQIPETARE

Ndoshta ka disa shqiptare, qofte neper qarke t' emigrantevet, qofte ne popullin qe jeton sot ne ne sundimin tiranik te Zegut, të cilët kujtojnë se lufta e tmerrshme ne Spanje eshte nje qeshtje kryekeput e vegante dhe qe nuk ka të benje aspake me te ardhmen e popullit t'one te ngrate. Ky eshte nje gjykim fare i ngushte dhe i gabuar qe nuk te lejon te shohesh qarte dy pika kryesore te kesaj perpjekjeje gjigande: nga njera ane qellimet kriminale te atyreve qe e shkaketuan rebellio- nin te Korrikut, dhe nga ana tjat- ter idealit e larte te lules se dja- leris demokratike qe i ka vene krahrorin rezikut qe iu-turr Re- publikes spanjelle ketu e gadi nje vjet e gjysme me pare.

Rebellioni i Korrikut nuk ka qene vetën kryengritja e disa gjenera- leve trathetare kunder qeveris se tyre legjitime. Ajo ka qene me te vertete qe ne fillim sulmi i pa- re i math qe i bene fuqit fashiste imperialiste botes se madhe de- mokratike. Po te mbajme kete fakt perpara syvet, mund t'a marrim vesh fare lehte e mire se sa te prekur jane shtetet e vegjel nga ngjarjet ne Spanje, dhe sido- mos Shqiperia, shteti me i dobet dhe komshiu me i aferte i ekspo- nentit te fashizmas. Mosinteresi- mi i shqiptareve ne luften e Spanjes eshte me teper se sa nje meskujdesje, eshte nje faj i rende kombtar, nje trathesi nga mos- dashja oso nga mosditja.

Ne kete shtylle te ngushte nuk eshte e mundur te jepen te gjithë shkakot per te treguar sa ngushte eshte e lidhur qeshtja shqiptare me ate te Spanjes. Ketu do te mundonemite bejme vetëm nje krahasim te shkurter per te pro- vuar se liria e popullit shqiptar dhe independenca e Atdeut te tij mvaren kryesisht nga perfundimi qe ka per te marre lufta ne Spanje.

★

Se pari, le te marrim para sysh hipotezen pas se ciles themi se lufta do te perfunduakesh ne fa- vore te fuqivet totalitare. Ne kete rast Italia fashiste do te vazh- donte me brutalitet edhe më te shtuar programin e saj barbar te ngadhenimeve te tjera. Do te per- piquej sidomos te siguronte dhe te forconte sundimin e saj eksploa- tonjes sidomos mbi shtetet e veg- jel. Imperiumi roman do te niste marshimin e tij te pandaluar- shem. Prej gadishullit iberik Mus- solini do t'i turrej siudhezes bal- kanike. Shqiperia, e derrmuar jashtezakonisht prej sundimit fa-

qezi te ketyre trembedhjete vje- teve te fundit, de te benej pa-nje- pa-dy kurban i pare i imperializ- mes italiane. Zati kurban Shqi- perin ia ka bere Zogu dhe klika e tij feudale Italise qysh me 1925. Por me rastin e nje agresioni te hapur kunder shtetevet te tjere balkanike, keta nuk de te rrinin me duar kryq. Dhe Shqiperia do te benej fusha e gjakte e luftes.



KAPITEN HULUSI SPAHIU: Bateria «Reçi» ka nje radio, qe artileristet te marrin vesh te rejat e te defrejne.

Ne kete çast ne shqiptaret. si do që te vinte filli i ngjarjevet, do te kishim per te humbur te gjitha, dhe asgje per te fituar. Shqi- peraret indiferente sot per qeshtjen spanjolle atehere do te shtreng- neshin t'u shtroneshin kushtevet te barabarta te temrrit te luftes dhe nenat shqiptare do t'u-ves- heshin ne te zi sikunder sot te ngratat gra spanjolle. Por ka edhe më keq. Ndersa popuj si- kurse i Spanjes kane mj aft fuqi jetonjese qe t'arifitojne ne kohet e arthme pamvaresin e tyre, me popullin shqiptar qendron puna fare ndryshe. Ky ndodhet qysh sot e trembedhjete vjet me pare gjysme-per-gjysme i roberuar; dhe me nje ndryshim te fuqivet perpjekese ne favore t'Italis fa- shiste eshte ne rezik t'a humba- se edhe eksistencen e tij emerore si shtet dhe te çduket perfunde- risht si komb prej lemshit te dheut e prej historis se njerezit- mit. Edhe perse i gjithë ky per- fundim tragjik per kombin t'one, o shqiptare? Se keshtu i pelqen Ahmet Zogollit dne qarkut te tij imediat feudal, te cilet, si ne ko- het e para ashtu edhe sot e kane nxierre Shqiperin ne mizat per te kenaqur interesat e tyre persona- le. Votimi i qeveris se Zogut kun- der Spanjes Republikane, dhe

njohj a e jantes se Burgosit per t'i bere qefin Romes (porse edhe xhepit te vet!) ka qene nje mahim rrumbullak i pamvaresis shqi- perare prej qeveris trathetare te Ti- ranes.

Ç'vlere do te kishin atehere te gjitha sakrificat bujare te pa- triotevet shqiptare veterane te rilindjes s'one kombtare?!

Dhe tani le te marrim para sysh

mundesi t'a rifitonje plotesisht li- rin e saj te humbur nde qofte se fashizma do t'i thyenje turinjtë per ngordhje perpara ketyre mureve te pakaperxyershem te Madridit. Perandaj te gjithë shqiptaret qe me te vertete e dashurojne Shqi- perin dhe popullin shqiptar e ka- ne per detyre kombtare te rresh- tonen ne anen e fuqivet demokra- tike dhe te Republikës spanjolle. Ne anen e fashizmes le te mbeten vetem ata qe sot pobejne rremu- je popullin shqiptar dhe tradhe- sisht e mohojne pamvaresin e Shqiperise.

★

Sa per na shqiptaret qe sot- per-sot ndodhemi ne rreshtat e ushteris se Spanjes Republikane guxojme te themi qe ketu jemi duke luftuar njekohesisht per te thyer armikun e neserme te At- dheut—duke nekuptuar per te til- le nje vend ku populli gezon liri e drejtesi dhe sundonet permes vul- netit te vet. Nene kushte te ke- tille, dezertimi yne prej ushteris shqiptare, qe eshte shtrenguar te benet roja e nje bande hajdutesh, intrigantesh e kriminelesh qe po bejnë rremuje Shqiperine, eshte plotesisht i justifikur moralisht; ne vend qe te duket nje aventure, resulton si pune e perfunduar me mend dhe e nevojeshme nga pi- kepamja e interesit t'one komb- tar. Ne jemi te ndergjegjeshëm per ate qe kemi bere dhe gezone- mi qe na eshte dhene nje rast por te treguar idealin t'one dhe da- shurin e vertete per vendin qe na lindi e per popullin, bijt e te cilit mbur remi se jemi. Aqe krenare jemi per kete ideal te paster, e per sherbimin qe i bejme vendit e popullit shqiptar ketu ne Span- je, sa jo rrogat qeveris tratheta- re te Zogut, që i flakëm vulneta- risht, por i gjithë floriri i botës nuk do të na vlente as sa nje rrahje e zemerës s'one per kete ideal.

Jemi te lumtur qe mundem t'a shpetojme vehten nga radhet e zyrtarevet te sotme te Shqiperise, nga pergjegjesia e rende qe do t'u bjere ne krye qe te gjithëve kur te vinje dita e gjyqit kombtar. Ne nuk bejme pjese ne grupin e tra- thetarevet te atdeut; ne qen- drojme lark atyreve. Ne qendroj- me ne anen e kunderte te atyre- ve; ne bejme pjese ne ushterin me fisniken, me guximtaren te botes, qe derth gjakun e saj per te shpetuar gjithë boten prej tmerrite prej zise, prej turpit e prej vdekjes.

HULUSI SPAHIU

NJE KOMANDANT KOMPANIJE

(Prej: Le livre de la 15ème Brigade Internationale **NOS COMBATS** contre le fascisme, Madrid, 1937, Mai.)

Gjyshi Puka ishte nje nga perfaqesonjesit e popullit shqiptar ne Brigadat Internacionale, dhe nje nga kryetaret t'one me te dashur. Aste 56 vjefet e moshes as te dy plaget qe ka marre ne frontet e tjera te Spanjes, nuk e kane penguar te vinje tek na. Me vuajtjet e tija te nje veterani plak



Omer Puka.

ka ditur t'a rrefenje zotesin e luftetarit. Qysh ne 1908 ka marre pjese ne levizjen liberale te xhonturqvet me Enver Pashen, ku tregoi vleren e tij te madhe.

Me 1918 mori pjese ne revolucionin rus.

Me 1920 u-kthye ne Turqi dhe luftoi ne ushterin e Qemal Pashes, i cili i dha nje shkalle shume te larte.

Porse gjyshi yne (sikur se thote) i ka dhene "Besen" Leninit. Per kete "Bese" u-shtrengua t'a lere Turqine dhe te kater femijet. Per kete "Bese" ka ardhur te luftonje ne Spanje.

Brohoritim me zjarr e dashuri: Rrofte Gjyski yne Puka. Dalte faqebardhe ne te gjitha lufttrat t'ona per paqe, perparim e liri, dhe pas fitimevet t'ona u-kthehte shendoshe e mire tek gruaja e femijet e tija, i lumtur qe e mbajti "Besen" e tij Shqiptare.

BETIM... DHE BETIM

Betim me goje, mallkim me zemer... Ushtaret dhe oficerat, ne Shqipenin e sotshme dy fish te robnueme, bajne kte betim:

"Me ndergjegjen e plote e te shenjtes ligje trashegimtare te beses, betohem se do te jem besnik ndaj Naltmedhin e Tij "Mbretit" Zog I dhe te trashgimtarvrt te tij ligjues, me respektue statutin dhe te gjitha ligjet e tjere te Shtetit, e me u ba fli per te miren e pa ndashme te mbretit e tatdheut!"

Ky betim esht perkthye fjale per fjale nga rregullorja fashiste italiane, qi nuk pyet aspak per vullnetin dhe sovranitetin e popullit.

E gjitha ushtria dhe gjindarmerija shqiptare mbahet ne kembet per te shtype cdo levizje te popullit kundra trathtorit Zog dhe zotit te tij, qi e solli dhe po e mban ne fuqi. Si prova kemi levizjet e Fierit, te Gjinokastres dhe grever e puntorvet te Kucoves. Per kte qellim ne levizjen e Fierit Zogu mobilizoi gadi te gjitha klasat e rezerves per t, i perdore kundra popullit te cilit i ka hype ne shpinde me perdhuni e me anen e tradhtis ma te nalte!

Por Zogu e ka kuptue se shumica e ushtrise asht kundra atij, dhe pran daj ne kohen e fundit ka fillue te marri masa qi do t'i sjellin, prap se prap, resultatin e kundert te dishrue nga aj. Oficerat e rij ma te miret, te gjitha akademista e perparimdashes, plot dashtni per vend e per popull, i nxjerr ne lirim dhe i mban nen verretjtje. oZgu ka nevojte per oficera si ata qi ka zgjedhur ne Mat, qi vejne imzane me gishtin tregues; se vetem ata mund t't quajne pshtymtarin e popullit "pshtimtar". Naturisht nga paditunija. Zogu ka nevojte si per lugin, kapiten Smajl Osmanin, qi te korrumpojne, te demoralizojne dhe te cnderonje biqt e mire te popullit shqiptar, sikurse ndodhi me te shkretin tetar te Shkodres, Latifin. Ky djale trim mori hakun e nderit tue derdhe gjakun e feligshte te cnderuesit. Por gjyqi ushtarak, perba prej partizanve te kapitenit qe "ra deshmor ne fushe e nderit" — se zogistet nuk kane tjetet fushe nderi — e denoi me vdekje tetarin "rebel" qe guxoi te veje ne rezik eksistencen e klubit "moralist", udhehequn prej "te vlefshmit kryetar nderi". Lal Krosit dhe sekretarit te pergjitheshem Pepa.

Kete denim skandaloz e monstruoz, qe nuk ka shembell krahasimi ne historin e gjyqevet te bo-

tes, e aprovoi kryetari i imoralevet te gjitha Shqiperis, vete oZgu.

Vllazen, ushtare, nenoficera dhe oficera te rinj shqiptare! Ju jeni te mesuar dhe inteligjente. Ju e dini se e mira e atdheut t, one qendron ne kundershtrim te drejtperdrejte me te miren e Zogut dhe te klases qe sundon sot Shqiperin. Ju nuk i kini asnje detyrim besnikije nje bande imoralesh, qe nuk ka ditur kurren e kurren c'asht besa e nderi e ligji. Zot e trashegimtar i tokes shqiptare nuk asht askush tjetet pervec popullit shqiptar. Ketij i detyroni bindje dhe besnikie.

Perandaj, me fjalën burmore te dhanun midis jush, qe ndjeni me atdhedashtni te zjarre konsekvencat e hidheta te regjimit tradhtar, prapanik e antikombtar — Bashkouni! Vetem ju, ne lidhje te ngushte me elementet ma te shvillueme e te ndergjegjshme te klases puntore e katundare — te lidhur neper mjet te penit misterioz e te padukshem per tradhetoret e popullit e agjentet te tyne mizore — do t i coni ne litar tiranet e popullit. Se, si thote populli vete: "Cdo send keputet ku asht ma se holli, zullumi kputet ne vendin ma te trashe", ashtu edhe regjimi zogolljan ka arritte kulmin e zullumit. Pritet vetem ditakur te pelcase furrija e turrmavet e t'a perfshinje aparatin shkaterrrimtar te Zogut me nje perfundim ma fatal se te dinastivet sundonjese te Turqis e te Rusis, qe pretendojshin se fuqija u vinte qe nalt nga qielli.

E mbas kesaj dite fatlume, me te vertete shpetimtare per Kombin shqiptar, te gjitha ne ushtaraket dhe vulnetaret do te betonemi ne ushterin popullore shqiptare para popullit vete. Si mbas kushtevet te vendit e rrethanavet te kohes s, ardhme, por betimi i joneka me qene i ngjajshem me betimin e Ushteris se Kuqe te Bashkimit Sovietik qe therr zemren e barkalecavet feudale dhe kapitaliste dhe tingellon keshtu:

"Une, biri i popullit, proletar dhe qytetar i Republikes popullore te Shqiperise, vete ushtar ne Ushterine e punetoreve dhe katundareve. Betohem para punetoreve dhe bujqve te Shqiperise dhe te botes mbare se do te msonj me ndergjegje mjeshterin e armevet dhe se do te mbronj, si t'ishte mishi dhe gjaku i trupit t'im pronesin e popullit.

Betohem edhe se kurre nuk do te baj asnje veper qe te jete e padenje e nje qytetari te Republi-

VULNETAR NGA ME TE PARET

KOSTE DHIMITRI LITO nga Leskoviku eshte tipi i punetorit shqiptar dhe jeta e tij dyzete-tre vjetesh nje liber i gjalle vuajtjesh e gezimi. Qe trembedhete vjetsh nisi te shijonje buken e hidhur te kurbetit. I ati Dhimitri se pari e qoi pas nje beu Leskoviqar, i cili qe doganaxhi n'Allasonje, dhe dy vjet pas hyrjetit e dergoi ne Stambolle qirak te sheqerxhiut bashkeqytetar Anxhopullos. Ky qe mesimi i pare qe mori nga shkolla e jetes. "Nga sa vuajta prej njerit usta bashkeqy-



Koste Dhimitri.

tetar dhe prej tjetrit, nuk vura re ndonje ndryshim midis njerezvet per shkak te fese", thote Kosta.

Mesimi i dyte eshte i lidhur me nje pendese "kombtare". Mizorit e shvilluara ne vendin e lindjes se tij perpara luftes botenore, barbarizmat e gjakta ne emer te kombsis, e kane bere Kosten te

kes popullore shqiptare, dhe se do te stervisi gjithnji mendjen t, ime kah qellimi bujar e njerzuer qe eshte naltsimi moral e material i proletariatit."

N'at kobe, me nje kuptim simbolik, do te vehet ne plumb gjenerali barkalec, harbut, xhahil, ish-bashqaushi anadollak, Xhemali, javeri Turgetevel dhe xhelati i foshujavet Kosovare me 1910, prej nje platoni ushtaresh t'urijshe deri ate dite — Shalnane, Myzeqare dhe Laber.

E. MYFTARI

Fronti i Liris,
Nanduer 1937.

bindet se është sistemi qeveritar që na bën të mire ose të liq. Dhe për të shpëtuar nga ky tmerr i math i jetës në vendin e lindjes, Kosta u largua në Paris më 1916.

"Gjaku im", rrefen Kosta, "kur degjonja që në Spanjë vriteshin argatet, shoket e mij të punës, me dridhej e nuk më linte të qete. Po të humbisnin ata atje, në ç'punë do të më hynin më hallatet e keqpevet, vec se për t'u ndertuar cizmet fashistëve, që të më shtypnin më lehtë edhe mua!". Dhe erdhi në Spanjë.

Dyzetedyvjeshari u jepte kurajë me të rinjvet.

"Në perpjekjen e parë me fashistët, të të them të drejten, më hyri pake frika. Pas njëdy ditësh kur na vinin avionet mbi krye dhe gjylet e topavet drejt fytyrës, u mendova: Porse kam frikë edhe une? Në Paris u-lutesha patro-nevet për punë. Më c'tallje na perzinin, ose më c'egersi na qasinin e na ripnin lekuren! Dhe kur vinte koha që të na paguanin — sa poshtersisht na grabitnin haken e fituar me djersën e ballit t'one! Të gjitha mizerjet e kohës se parë më erdhën që ditën e dytë në koke. Femijet, argatet, bota e mizerjes më bëri të mendonj që vetëm fitimi i proletariatit do t'a ujdite këte botë të padrejte. Dhe une vete mendova që isha një pje-sez' e vogël, një therrime e punetoris se botes... Frika duhej të më shporrej prej gjoksit. Le të vinte ku të vinte; në një zëmër fashisti, po të donte. Por une nuk kisha nge t'a mbanja më tepër. Që atë cast vendosa të bënj besnikerisht detyrën e luftëtarit proletar. Dhe besonj se që prej atij momenti fashistët nuk m'a kanë parë ndonjë herë kurrizin."

Kosta është nga më të parët që ka ardhur në Spanjë prej Francës. Pas pesë ditësh udhëtimi, ka arritur në Albacete më 22 Tetor me brigadën Thälmann. Më 12 Nëntor mori pagezimin e zjarrit në P de los Angeles, dhe vazhdoi luftën në Fuencarrel, Casa del Campo, Cita Universitaria, dhe aJrama. Në të fundit më 14 Shkurt u-plagos rëndë prej një eksplozivi përmes brinjave midis hijes dhe kofshës së këmbe së mëngjër. Pas katër muajsh në spitalin e Castelljon Bujana, u kthye në Madrid dhe u-mbait në Cuartelin general të Kumandës së Brigadave të Internacionale.

Përmes punës së tij të mirë imfitoi mbesimin komandës. Dhe sot është Responsabel i një zyre me rëndësi.

PERSE LUFTOJME NE SPANJE

Kur plasi revolucioni në Spanjë tere bota shqiptare priste me padurim triumfin e frontit popullor.

Krimet, shkatërrimet dhe rrenimet që fashizmi tiranik përdori që në fillim për të përhapur regjimin e tij të mizerjes egersonte pa mase çdo bër të Shqipërisë. Sidomos kur fashizmi italian dhe ay gjerman derguan mercenaret e tyre për të ndezur Spanjën e ngri-tur me kembë për lirin e saj atëherë populli ynë nisi të shqetsohej dhe të ndjente thellë për Spanjën popullore dhe të urrente një mije herë diktaturat imperia-liste të Romës dhe të Berlinit.



QAMIL SHERIFFI

As pleqria as oqeani s'e ndaloj dot të vinje nga Shtetet e Bashkuar drejt në Spanjë dhe të marrë pjesë në luftë krah-per-krah me shokët e batalionit "Washington".

Në Tirane, në Korce në Shkodër e kudo gjetke ku arriu "shtyp-i kombtar" dhe valat e radios ndiqej më vemendje trimerija, the-rorija dhe shembella e lartë e Po-pullit heroik të Spanjës. Çdo pëllembe toke e humbur, çdo bom-bardim kriminal i avionit fashist mbi femijë e gra egersonte masat popullore shqiptare.

Dhe për të marrë hakun, për të ndihmuar heronjtë e Spanjës, shumë djem të popullit t'one lanë vellezër e motra, prinder e femijë, i lanë nënë terrorin e regjimit të uris dhe iken plot vullnet, plot zjarr, duke kaluar kufinj shtetesh fashistë, dhe erdhën këtu, në truallin e perpjekjeve për lirin e Spanjës dhe të botes nga rezi-ku i fashizmit nderkombtar. Porsa u-perhap lajmi në tërë vendin t'one se edhe shqiptarë shkuan në Spanjë—sa gezim dhe enthu-siazem ndjeme, sa zemra u-ndeze! U-ndezen plot mburrje zemrat e tërë djaleris revolucionare, zem-rat e punetorevet të shtypur, dhe sidomos zemrat e sklaveruara të bujqvet t'ane të mjere! Dhe të gjithë, të gjithë këta kishin një

fjalë levdate për vullnetarët shqiptarë të Spanjës. "U-lumte!"

Mirë, po atje në Tirane, ku problemet kombtare zgjidhen rreth trapezës së mastikës disa nga të ashtuquajturit "ajka intelektuale" dhe "patriote veterane" thanë me keqardhje: "Si more! skuan në Spanjë? Ç'bene! perse nuk vranë këtu një dy nga kriminalet e po-pullit dhe pastaj të vdisnin më nder! Kalamajt! Shkojnë në Spanjë dhe vriten kot me se kot!... Sa para vlen gjaku i tyre në mes t'atyre lumenjve të kuqeruar..."

Dhe a e dijeni? Këta që flasin kështu në Tirane e quajnë vehtën



BIM KURANI

Në spitalin amerikan, ku shërben si shkronjës disa muaj, u shërnua krejt nga plaga e Brunetes dhe tani u-kthye në mitralozin besnik i tij në batalionin "Lincoln".

revolucionare. Por a e dijnë vallë ata "revolucionarë" qëllimin edhe kuptimin e lartë që ka gjaku shqiptar i derdhur në llogoret e Spanjës? Doemos jo, se po t'a dinin do të vinin edhe ata vete këtu dhe përpara se të binin the-rrore do të kishin gezimin të ndihnin një herë erën e pastertë të Liris. Doemos nuk e dinë, per-randaj do t'u a kallezojmë që këtë:

Këtu në trencet e frontit të Liris gjendet ajka e jerezimit. Nga cilido vend i botes kanë ardhur vullnetarë dhe luftojnë duke qenë gati të bëjnë sakrificin më të math që ka njeriu: jetën. A ka gje më të lartë në botë kur një vetedashës fal jetën e tij për Li-rinë? Po, më mijera njerës punetore, intelektuale, ushtarakë lanë vatrën e tyre q'enjen e tyre dhe vrapuan këtu për të derdhur gjakun e tyre. Dhe perse e gjithë kjo? Se janë "budallenj" apo "te deshperuar"? Jo mor mik e vella! Këta mijera e mijera shokë nder-kombtare që luftuan dhe pu luf-tojnë me vullnet të hekurte krah-per-krah me popullin trim të Span-jës e dinë fare bukur se perse

luftojnë, se janë ajka e njerezisë, janë perfaqësuesit e shtresave të popullorë me progresive të dheut. Dhe ja perse luftojmë: t'i shtypim këto fashizme nderkombtare që kërkon të nbyte botën në gjak, që kërkon të përhapë terrorin dhe zënë në tërë popujt. Se këtu në Spanjë Mussolini dhe Hitleri, të dy kriminelet e kohës që më vdekje sundojnë dy popuj të mëdhenj, duan të provojnë fuqinë e tyre, duan të shkaktojnë një permbytje gjak-tare të Njerezisë. Perandaj vullne-tare nderkombtare vijne këtu për të luftuar se më therrorin e tyre i bëjnë varrin regjimit fashist nderkombtar dhe e ndalojnë të hedhë rrënjë natë e tija hrlmonjese këtu: i thyen me grushtin e tyre hundet Francos, i cili sot është vegla e diktatoreve imperialiste dhe e kapitalistëve të mëdhenj të botes.

Ju atje në Tirane e kudo që jini, e kuptoni perse kemi ardhur këtu dhe luftojmë krah-per-krah me mijera e mijera shokë të ardhur nga të katër anët e dheut? E kuptoni perse më grushtin e Spanjës republikane dridhet fashizma in-ternacionale? Kini marre venh perse derdhet ky gjak i kulluar i njerezve më të njohur të dheut? E dini që çdo pike gjaku luftetari popullor siguron Paqen, Lirin dhe Buken e Njerezisë? E dini se kockat t'ona nesër do të jenë roja e Dretjtesisë dhe e Je-tes? Eh, ndë mos e ditshi, pyesni organet e feliqurës së sundimtare-vet kriminale dhe, po të jenë të singerte, do t'ju a thonë që Span-ja do t'u a hajë këto. Ata e dinë fare mirë që triumfi ynë këtu është vdekja e atyreve. Ata? Ata e kanë kuptuar fare qartë perndaj perdo-rin që mjet për të ndaur ardhjen e vullnetarevet shqiptarë këtu. Se po të që ndryshe, ata do të kenaqeshin më ikjen e shumë ar-miqve të regjimit nga Shqipëria. Apo mos përnjehetesh kanibalet e Tiranes janë bërë aqë të njerezis-hem sa t'u vinjë keq t'i lenë ar-miqët e tyre të venë të vriten në Spanjë? Por e dinë ata se sa më tepër të jemi në këtu aqë më lehtë e shpejt do t'u ndanë prifti gruret dhe hoxha do t'u kendonjë pas veshit.

Aj që nuk e ka ndjere edhe trumbeten e Liris, le të zgjohet; nesër gjaku i deshmorëvet t'one këtu do të këlthasë aqë fort më kushtrim sa do t'a tronditnjë çdo sklav të shtypur të çohet për shli-rim.

SALUD!

NE

Në vazhdim të gjysmës, këto vije në Spanjë jesisht. Dy mirë qendro, le njëra të ngjarjet dhe nga strategji rasti. Se-pas gadat inter-vojeshme vetë-dergoneshin pregatitjen e keradhitjen e Brigadat In-pjesë e parë njese.

Po të kishte therritë në njollë një disiplinuar historia e pa do të kishte me. Detyra e ka qenë të rebelevet më që të shtinte tej kohe për plinë në shk-gene e dom-mbeshtetëjtë inspiruar në për një që mbesonin.

Vtediscipli-tonje për një let qendrojn-re më një shkalla e dhe puna bashkerendi-plines shton e domosdosh-drore të jete-sim në togj-e saja sa t-shpejt dhe tjera, bindje-tyruarshme ushterije të

Në ditët dime janë kombtare. kjen e Brun-më fort u-mbi meritën se sa të v-Kjo fare sj-prej botes sa zorr esh-antifashist te vjeter. N e kundersht-ne dore të Tani luftoj-tyre, por po-toriteti, në është në an

DISCIPLINA NE USHTERIN TONE

Ne vazhdimin e gadi nje vjeti e gjysme, karakteri i Luftes Civile ne Spanje Landryshuar rrenjesisht. Dy ushteri te stervitura mire qendrojnë tani balle-per-balle njera tjetres. Perfundimi i ngjarjeve do te mvaret me shume nga strategjia se sa nga fati dhe rasti. Se-pari kur u-formuan brigadat internacionale, qe e nevojeshme vetem shpejtesia; togjet dergoneshin ne vije te zjarrit me pregatitjen me te pake dhe bashkeradhitjen me te vogal. Por tani Brigadat Internacionale jane nje pjese e pandare e forces luftonjese.

Po te kishte qene e mundur te therritej ne arme prej tokes spanjolle nje ushteri krejtesisht e disiplinuar qe ne plasje te luftes, historia e pastajme e ndodhinave do te kishte qene fare e ndryshme. Detyra e qeveris nder ato dite ka qene te ndalonte perparimin e rebelevet me cdo menyre o mjet qe te shtinte ne dore. Nuk i mbe-tej kohe per te organizuar discipline ne shkalle me te gjere. Ka qene e domosdoshme atehere te mbeshtetej ne vetedisciplinen e inspiruar ne njerezit qe luftonin per nje qellim ne te cilin ata mbesonin.

Vtedisciplina mundet te mjaftonte per nje tog njerezizh te cilet qendrojnë ne lidhje te papre-re me njeri tjetrin. Porse kur shkalla e organizimit zgjerohet dhe puna e togjeve te vogjel bashkerenditet, problema e disciplines shtonet me te teper. Benet e domosdoshme qe komanda qendrore te jete e zonja te kete mbesim ne togjet qe zbatojne porositet e saja sa te jete e mundur me shpejt dhe me mire. Me fjale te tjera, bindja pa kusht eshte e detyrueshme per formimin e nje ushterie te stervitur plotesisht.

Ne ditet e lashta, shume bisedime jane bere ne radhat nderkombtare. Edhe gjer ne perpjekjen e Brunetes, ka patur disa qe me fort u-pelqente te bisedonin mbi meriten e nje urdheri te dhene se sa te vraponin t i bindeshin. Kjo fare sjellje eshte trasheguar prej botes se vjeter, dhe tregon se sa zorr eshte medje edhe per nje antifashist t'i prese zakonet e tij te vjeter. Ne vendin t'one dëndur e kundershthonim autoritetin, se qe ne dore te njerezve te padrejte. Tani luftojme kunder aliatevet te tyre, por pozita ka ndryshuar. Autoriteti, nen te cilin sherbejme, eshte ne anen t'one. E kupetojme

sot qe cdo urdher eshte pjese e nje plani te tere, dhe qe mungesa e zbatimit te cilitdo urdheri mund te rezikonje te gjithë planin.

Kjo ka qene veshitresia e vulnetarit: te njohe ndryshimin midis njerit lloj autoriteti dhe tjetrit, dhe te kembenje edhe atituden e tij pershtatshem. Eshte nje veshitresi e cila pothuaj se eshte kapexyer gadi krejt. Tani togjet e

Brigndavet i sundon nje fryme e cila eshte fare e re. Rekrutet e rinj qe jane stervitur no baze te disciplines se re, i kane ndihmuar ketij ndryshimi. Anetaret me te vjeter i jane pergjegjur. Nje nga shfaqjet me interesante te jetes ne Brigadat ka qene zotesia e shokevet per te bere kembimin drejt permiresimit. E ketille eshte influencia e ushteruar mbi ata permes qellimit te bashkete, qe nevojat per ndryshim kane nje efekt korespononjes mbi anetaret vete...

The Volunteer for Liberty.

OFICERET SHQIPETARE NE BRIGADAT INTERNATIONALE

Pas luftes se nxehte te Brunetes dhe nen qiellin pervlonjes te Madridit te dy kapitanet shqiptare gezonen qe nund te qlodhen pake ne hijen e nje peme. Qe te dy kane patur detyra te renda ne keto kohe te veshtira. I kane kryer mbanen e mbare dhe duken te kenaqur.

Keta te dy shoqe Kosovare ka-

ka qene vendi klasik i trimerivet, kete nuk na e ka mohuar askush. Por oficerat e ikur prej akademis fashiste te Italis, te ikur prej ushteris ze Zogut qe shtyp popullin shqiptar, i shpallin botes qe atdheu i tyre i vogel nuk ka shterrur krejt ne vetijal e dlira qe po benen pronja e gjithë njezimit te perparuar. Eshte me




Kapitan **Shaban BASHA** dhe Kapitan **Veli DEDI**.

ne qene nder te paret qe lane Akademín Ushtarake te Torinos dhe erdhen te luftojne ne Spanje. Me veprën e tyre heroike, duke përcmuar te gjithë shperblimet e nje jete te pasur materialisht ne regjimin fashist dhe duke perqafuar qeshtjen e proletariatit si te tyren, na japin ne shqiptarvet te tjere nje shkak mburrjeje perpara te gjithë botes. Qe Shqiperia

fort per t'u-gezuar qe sot ne Shqiperi jane oficerat e rinj qe kane ngrehur lart flamurin e nderit e te idealizmes.

Oh, sikur t'a kuptonin qe te gjithë oficeret shqiptaret te verteten, qe sot nuk eshte qeshtja vetem per shpetimin e Shqiperise, por qe sot eshte qeshtja edhe per nderin e Shqiperise!



Kap. **Spahiu** inspekton bateriun «Reci».

TRANSMISIONE NE GJUHEN SHQIPE

I paharruari shok Asim Vokshi, me entuziazmen e nje ushtari qe interesonet per te gjitha fazat e jetes, ne dy letra te derguara ndonje muaj para se te binte deshmor dhe qe i mbajmë si testament te tij na shpiegonte midis te tjerave edhe punen qe duhet te shvillojme me anen e radios. Disa emisione u-dhane nga Valencia, dhe u-pezualluan me shpernguljen e aparatit nga ay qytet. Tani i lajmtojme shqiptaret se, qe t'a plotesojme pcrosin e shokut t'one hero, do t'i rifillojme trasmissionet ne gjuhen shqipe me *Radion e Barcelones, vala te shkurtat*, 42:75 m. ne 23 Dhjetor, ne oren 20:45 mbremavet.

DY SHQIPETARE MERGIMI

THOMA RUSHANO, shoku arberesh, me pushken ne krahe, me githaren ne dore, dhe ne buze perhere ndonje kenge te bukur nga ato qe shpune stergjyshet e tij shqiptare ne Kalabri, u-nis per ne Bat. Lincoln.

STEVENS THANAS, shoku barbac i ardhur nga Amrika, u-shrua fare mire nga plaga, dhe perseri u-nis ne balle te luftes.

SPANJA NUK ASHT ABISINIA.—Gjenerali MIAJA.

MADRIDI KA PER TE QENE VORRI I FASNIZMIT.—Dolores Ibarruri (PASIONARIA).

MA MIRE ME VDEKE MEKEMBE SE SA ME JETUE NE GJUNJE.—PASIONARIA.

MA MIRE ME QENE E VEA E NJE HEROI SE SA GRUEJA E NJE FRIKACI.—PASIONARIA.

MBESONJ NE FITORJEN MBASSI MBESONJ NE POPULLIN TIM.—ALVAREZ DEL VAYO

NJEZETEPES E VJET INDEPENDENCE!

Kur ungrit flamuri i Shqiperis ne Vlore me 28 Nentor 1912, e brohoritem me mbesim se kjo dite kishte per te qene fillimi i nje jete se re te lumtur per popullin shqipetar. Kujtuam shekujt e panumurte te kohes se ardhme plot liri, pune te ndershme, ndertime te pasura ne nje atdhe qe do t'ishte krejt yni, ne nje Shqiperi, qe do t'ishte independente. Perandaj u-gezuam.

Kishim shkak qe te gezoneshim. Peseqind vjet nene zgjedhen e Sultanevet do me thene nje tmerr qe nuk e rrefen dot fjala. Ne kete epohe u-kthyem peseqind vjet prapa drejt mesjetes. Humbem pjesen me te shendoshe te popullit ne luftra te gjakta per liri, me te miren ne mergim e n'arratisje: Qytetet me te bukur u-benc ger-madha. Ne Shqiperi nuk mbeti me shenje qytetrimi. I huaji, barbar, na i ndaloi institucionet, qe do te na lartesonin, na ndaloi edhe gjuhen vete. Te rrosh kage kohe nene kush-te te ketille do me thene te sbresesh ne shkallen e kafshevet. Sundim-taret e huaj na vrane shpirtrisht, na vrane edhe truprisht. Na grabiten pronjat komtare dhe u-a fa-len atyreve, qe u ndihmuan te na shtypnin. Keshtu, krah-per-krah me zgjedhen e huaj ngrehu mbre-trin e tij gjaktare mbi koken t'one edhe tirani i brendeshem, hajduti i vendit. Kajmekami dhe mytesa-rifi turk—beu dhe pashai shqipe-tar: ja te dy pale forcat shtypese qe e mbajton popullin shqipetar ne zgjedhe katerqintepesdhjete vjet plot.

Shpallja e Shqiperis independen-te tani me nuk ishte vetem nje en-derr e bukur; u-be historikisht ngjarje e vertete, realitet. Per-pjekjet e patriotetve idealiste u-kurorozuan me ngrehjen e flamur-it te Skenderbeut. Por ja qe nie komb nuk u-beka-i lire ne njezetekater ore, as ne njezetepe-se vjet. Sistemi i vjeter nuk u-spastrua krejt; shume rrenje te semura, mbeten ne trupin e kom-

bit te ri. Syresh po vuajme sot dhe do te vuajme gjer sa te mos kujdesemi t'i qkulum keto rrenje. Shqiperia lindi me cen. Deshires se Osmanllinjvet te na mbanin edhe me ne robri, ia zune vendin aspiracionet imperialiste te shtete-ve tjere. Dhe mungesa e nje kul-ture kombtare ne anen t'one u dha rast te na percqanin kombta-risht. Ne kete mes, klasa e feu-dalevet shqipetare, q'i kishte sher-byer aq besnikerisht me pare im-perializmes turke, nga frika se mos populli shqipetar i lire ia ri-merrte dherat e grabitura, hyri ne mbrojtje te te huajvet. Keshtu i shohim keta proprietare te med-henj tokash ne preher t'imperia-lizmvat austriake dhe italiane; dhe kur imperatoria duale morri fund u bene besnike te imperia-lizmes italiane fashiste.

Simbolikisht e kqyrur, vendi ku valoi se-pari flamuri i Shqiperis se rilindur qe nje shenje e keqe. Sa-rajet e Volres ishin ndertuar me kockat e me gjakun e mijra pune-toreve. Ne budrumet e tyre qene va rret e sa-e-sa bujqve shqipe-tare, te thirrur si mysafire dhe te therrur pabesisht, se kishin kun-dershtuar t'u falnin stergjyshevet te Xhemil beut token me te cilen ushqenin femijen e tyre varfabja-ke. Grat e qytetit ishin mesuar nga ndjenja e nderit te shkonin ne punen e tyre prej udhes me se larges nga keshtjella, ne bashodat e se ciles thuhej se degjoneshin paheshtur e parreshtur gjemat e gravet te grabitura perdhune. Me te drejte, pra, tutshem afronej po-pulli duke pyetur: "A mbi kete burg u-ngrit flamuri i Shqiperis se lire?" Keshtu pyeti tete vjet me radhe. Dhe kur e ndjeu fuqin e tij te rritur, plot urrejtje qe buçiti si vulkani, e gremisi burgun e tiranis qe nga themeli, tok me ate edhe sundi-min e feudalevet te brendeshem edhe imperializmen e jashtme. Zo-troi fryma liridashese e ketyre

barinjve dhe bujqve ne te gjithë Shqiperine, kur populli i bashkuar ane-mbane u vuri drune ne Qer-shorin 1924 forcavet te reaktionit dhe themeloi regjimin e vet.

Por lumi fle, armiku s'fle. Pas gjashte muajsh ato forca te shpo-rrura, te ushqyera prej imperia-lizmes jashte, lu-versulen perseri popullit shqipetar dhe e gjakosne rende ate ditën e mallkuar te 24 Dhjetorit. Fajtoje ka per te mbe-tur guverna e atehereshme qe nuk ia mbajti popullit me kujdes pen-kun. Sikur te kishte qendruar krah-per-krah me turmat, te kishte organizuar fuqirat e nder-shme, te shendosha, te mencura, t'u kishte dhene fuqin ne dore bij-vet te vertete te vendit, dhe te mos kishte bere kompromisa me miq t'armiqvet te popullit, feu-dalet dhe reacioneret nuk do te kishin shkelur me ne toke, te trembedhjete vjetet e fundit nuk do te qene shkruar ne histori te Kombit shqipetar. Porse qeveria u la kohe trathetarevet te mbled-hin ndihma te huaja kunder Shqiperis. Passi zgjedhen kuman-darin e tyre, me te rin nga mosha, me di nakun nga mendja, me te poshttrin nga shpirti, e nisen sul-min e tyre si ujë t'uretuar drejt kopese. Hyrja e Wrangjelistevet ne Tirane nuk eshte vetem triun-fi i maskarallekut: Eshte triunfi i trathetis se klases feudale mbi te drejtat e popullit shqipetar, te ciit i vuril mbi koke sundimtar e "mbret" armikun me te math te Kombit, te Perparimit e te Liris.

Aqe fot ua ka patur friken reg-jimi i sotshem bujqvet dhe pune-torevet shqipetare, sa edhe passi i çarmatosi krejt dhe pushkat e ty-re ua dha qahallarevet dhe te zo-tervet, e gjeti te nevojeshme te blere zyrtarisht edhe ndihmen mi-litare te shtetit qe e mban akoma sot me-kembee. Eshte e domosdo-shme te radhitim aty pazarlleket qe ka bere ne dem te vendit per te siguruar sundimin e pronjare-

vet te mbedhenj dhe autoritetin e vet mbi popullin? Po keto i dime te mbedhenj e te vegjel aqe mire sa e dijme edhe te verteten qe sot n po vuajme nene vazhdimin me te rrepte dhe mete ndjere te tira-nis otomane. Perseri po shkojme drejt humbjes se plote te pamva-resis se kombit, perseri po ngry-semi ne naten e roberis, ne ank-thin e kohevet te erreta, qe ia kane pregatitur botes fashizma barbare. Trashegimin e namur te fanatizmes e te ignorances qeve-ritaret e sotme po e'perhapin ne te gjithë popullin e mbetur prapa nga qyterimi, dhe po i futin grind-jen qe te mundin t'a mbajne nen'urdher. Dhe ne vend qe te na si-gurojne lumturin e paqen, po na pregatisin mjerimin e nje lufte rrenonjese. Drejt kesaj gremine po na shpijen me traktatet poli-tike dhe militare te lidhur me shtetet fashiste, me koncesionet ekonomike dhe financiale qe u kane dhene shoqrvet italiane, dhe me kapitulacionet qe shqipetaret duhet t'i durojne dashur padashur. Na kane bere nje gjysme-koloni, nje mehalle jevgesh, te Italis fa-shiste. Mbi kurrizin t'one po pre-gatit Mussolini shkallen e pare te penetracionit roman ne Balkanet. Shqiperia eshte ne thonjt e kulq-dres fashiste. Per t'a shpetuar, duhet t'i japim grushtin e vdekjes feudalizmes dhe fashizmes ne ven-din t'one.

★

Eshte, po, nje perpjekje e ren-de, per jete a vdekje. Por nuk do të qendrojme vetem ne kete lufte t'ashper. As qe nuk mund te qen-drojme vetem. Sot e gjithë bota eshte e ndare ne dy balle te kun-derte: te fashizmes dhe te demo-kkratis. Po lozet shume ne keta te dy balle per fatin e popujvet te vegjel te dobet. Çdo gje qe ngjet sot ne nje shtet e per nje shtet, benet qeshtje e botes mbare. Kun-

CE!

utoritetin e
keto i dine
el aqe mire
teten qe sot
zhdimin me
jere te tira-
po shkojme
te pamva-
ri po ngry-
is, ne ank-
reta, qe ia
s fashizma
e namur te
ances qeve-
erhapin ne
etur prapa
utin grind-
mbajne nen'
e te na si-
gen, po na
nje lufte
j gremin
tatet poli-
lidhur me
koncesionet
iale qe u
aliane, dhe
shqipetaret
padashur.
me-koloni,
Italis fa-
ne po pre-
e pare te
Balkanet.
t e kulçe-
shpetuar,
e vdekjes
es ne ven-

der fashizmes imperialiste, qe pre-
gatit lufte per ngadhenimin e
shteteve te dobet, do te na vinje
ne ndihme proletariati paqeda-
shes, qe u ndihmon popujvet te
vegjel te mbajne pamvaresin e
tyre.

Naturisht populli shqiptar nuk
kerkon lufte vete. Do te mbanje
paqen. Vetem ne gjindje paqsore
mendon t'arrinje ne demokratizim
e plote te masave. Vetem
keshtu do te jete e mundur te
shpetonje nga lakmit e shteteve
te medhenj imperialiste dhe te
mbledhe fuqit per te permbysur
diktaturen e brendeshme. Ecen
pra, ne gjurmat e demokrativete
medha, qe perpiqen te mbajne pa-
qen dhe interesonen per shkrimin
t'one. Mire, porja qe fashizma
eshte lufta vete; ajo rron e rritet
e gjakun e me viset e popujve te
huaj. Dhe shume dukje tregojne
qe hija e zeze e lufte po shtonet.
Nje lufte te tmershme po ia pre-
gatisin botes fashizma dhe forcat
e reacionit internacional.

Populli shqiptar e di fare mire
se q' do te thote per ate nje lufte
e pergjitheshme. E ka ndjerë ne
lekuren e vet nga lufta e madhe.
Ajo do te thote nje nderhyrje e
shpejte militare italiane ne te
gjithe Shqiperine. Mbi Milot e ne
Librazhd, do te valvitet Shqipja
romane. Zogolli dhe feudalet e tje-
re do t'a dergojne ne kasapanen
e militarizmes fashiste te gjithe
biqt e Shqiperise. Edhe populli i
varfer do te shtrengonet te sher-
benje me mushk, e me gomar qe
te fitojne armiq e tij; dhe keshtu,
pa dashur e pa ditur, do te shka-
terronje vete-vehten. Ja, pra, mo-
menti historikisht i rendesishem
per te gjithe patriotet e mire, qe
te provojme se nuk e kemi hum-
bur as shpresen as vulnetin per te
rifituar odo gje qe e kemi hum-
bur, qe na e kane rrembyer. Ko-
het jane me te vertete te veshtira,
sikunder eshte e gjate udha qe
do te ecim. Por q'na lyp atdheu
nuk do t'ia mohojme kurren e
kurren. Te gjithe do te hidhemi
ne fushen e arresimit te kombit
t'one dhe to t'a drejtojme kunder
diktatures se Zogolli dhe militar-
izmes italiane ne Shqiperi. Se
shqipetaret nuk kane ngë te der-
monen ne sherbim te imperializ-

mes fashiste. Ne duhet t'a shpe-
tojme popullin t'one nga vete-
vrasja, dhe t'a shlirojme nga ve-
rigat e robrit dhe te pakteve me
te cilet e ka lidhur Zogolli me
Italin fashiste. Ne nje lufte te
pregatitur prej ketij ne duhet te
bejme odo gje te mundur qe te
humbase fashizma dhe te shpe-
tonje Shqiperia.

Nde qofte se ne do t'i viremi
me mish e me shpirt vepres se


umb nuk duhet te shtiret kunder
vellerzerv et, a kunder shoqevet
t'one lufte. Plumbat t'i kemi per
trathetaret, qe na shtine ne lak
heronj si Themistokli Germenjin
dhe Bajram Currin; kunder vra-
sesvet te Gurakuqit dhe t'Avni
Rustemit, kunder atyreve q'i kane
grabitur popullit shqiptar token,
dhe tani perprgen t'i rrembejne
zemaren. Na duhet t'a shpetojme
popullin shqiptar nga tragjedia

dhe te dishfatavet te kohes se
kaluar, qe te heqim perfundimet
e desheruar. Thema me te lejua-
ra mbi mundesira legale duhet te
jene ne urdherin e dites.

... Prej djaleris shqiptare ka-
qe guxim mund t'a presim sa
te dale forra per amnesti te plote
te burgosurvot politike, me rastin
e festimevet; per zgjedhje legale
te perfaqesonje svet te popullit, te
cilet gjer tani jane çuar ne Par-
lament me porosi; per liri te plote
te mesimit ne per shkollat; per
lejimin e organizimit te punetore-
vet e bujqvet ne shoqirra te
pershtatshme, e tjera.

Ne rast shtrengimi Zogu, i me-
suar t'ua puthe doren atyreve qe
nuk ua kafshon dot, do t'i benje
edhe popullit koncesione. Edhe
me pare ia ka bere ndonje te
vogel ne rrethana te ketilla. Qe-
veria e Frasherit qe nje peshqesh
pajtimi, qe satrapi nen masken e
reformatorit ia dha popullit te
zemeruar nga barbarit e Fierit.
Edhe nde qofte se "Kabineti i te
rinjvet" nuk tregoi asnje zotsi nga
ato qe lypte misioni i tij i rende,
dhe keshtu shkaktoi ardhjen e
qeveris reacionare fashiste te
Koco Kotes ne fuqi, prape ky
shkembim i keq e ka patur nje
te mire per ne: ka forcuar edhe
me teper urrejtjen e popullit kun-
der Zogut dhe klikes se tij. Eshte
detyra jone tani t'i organizojme
keto turma te pakenaqurane ne
nje front te bashkete, t'u shtojme
mbesimin ne fuqit e tyre, t'i ndaj-
me nga qeveria, t'i bindim qe nga
sundonjesit rrjepacake qe ka mbi
koke te mos prese asgje tjater
perveç se te keqen. Eshte idea qe
te ngjallim iden e Frontit Popul-
lor edhe ne Shqiperi, dhe t'a
drejtojme kunder regjimit. Me
anen e Frontit popullor do te
perpiqemi te shembim regjimin e
sotshem diktatorial fashist dhe te
sigurojme bashkimin ne themel te
nevojavet demokratike dhe te
shvillimit nacional.

Ja qe liria nuk u-fituaka me
fjale e me frikë, ajo lyp zjarr ne
zemer e gjak te gjalle. Qe sot,
diten e njezetepese-vjetorit te
ngritjes se Flamurit le t'i pervis-
hemi punes; qe sot te fillonje
levizja per lirin e pergj theshme,
qe te perseritet e te plotesonet me



STALIN

U dha popujvet t' Unionit Sovietik Konstitutën më të lirë dhe më
demokratike ë botë.

shlirimit te vendit t'one nga tira-
nia, qofte kjo e brendeshme ose e
jashtme, i gjithe populli do te na
vinje pas. Nuk ka veç se t'i fi-
tojme zemren, t'i futemi ne shpirt,
t'a bëjmë të kuptonje qe luftojme
per te miren e tij; te jem gjithe-
nje me popullin, t'a shoqerojme
gjer ne kasollen e tij, ne aren e
tij, ne punen e tij te perditeshme;
te vemi ne kudo qe vete ay, ditën
e pazarit, ditën e te kremtevet,
ditën e nisjes se tij per ne ushteri.
Ne duhet t'i drejtojme udhen, ne
qellimin, ne pushken. Asnje pel-

e vellavrasjes gjate lufte se
madhe Europiano kur Drini dhe
Shkumbi, Devolli dhe Vjosa va-
luan kater vjet rrjesht me gjakun
e katundarevet t'onë.

Puna jone sistematike per te
arresyer popullin me detyrat e
tija rreth qellimevet t'ona shli-
rimtare duhet te nise sa me pare,
pa plasur hufta e pergjitheshme.
Qe tashti duhet te caktonet takti-
ka e ardheshme per te fituar te
drejtat t'ona dhe lirin. Eshte e
nevojeshme qe te benen mbledhje
per te gjetur shkakët e fitimetet

lavdi kombtare qast i Lushnjes dhe i Vlores. Shpejt ka per te ardhur dita e shlirimit te plote te atdheut. Perseri do te vinje casti kur fryma heroike e barinjvet dhe bujqvet vlonjate do te push-tonje zemren e te gjithë shqipeta-revet. Atehere me vulnetin t'one te pathyer, porse edhe me ndih-men e shoqevet t'ane te Italis de-mokrate, do t'a mbarojme vepren e shlirimit kombtar, do t'a ken-dojme kengen e Liris ne Sheshin e Flamurit te qdo qyteti dhe fsha-ti shqipetar. Nde qofte se me 1920, kur pa arme, pa shprese, pa pri-tur ndonje ndihme nga jashte, por vetem nga deshperimi dhe per te shpetuar nderin kombtar, nje kra-hine ngriti krye dhe e beri krye-tarin e fashizmes te derdhe lote inati, — epo tashti, qe kemi per-krahese gjithë boten demokratike, qysh esht e mundur te humba-sim?

Udha e re qe i çelet popullit shqipetar eshte, me nje shprehje, antiimperialiste, antifashiste, anti-feudale, antizogolliste; eshte de-mokratike ne baza te nje bashkimi dhe shvillimi kombtar. Permes ke-saj udhe duhet te kalojne te gjitha fuqit progresive te popullit, te gji-the patriotet dhe veteranet e kombit, e gjithë klase e aristo-kratis se rene poshte nga dynjal-leku, te gjithë tregtarët e dores se mesme dhe industrialet qe jane ne rezik te benen borçllinj te ka-pitalizmes italiane, borgjezia pro-gresive antiimperialiste, doemos te gjithë bujqt e punetoret, te gji-the, qofshin katholike ose mua-hamedane ose orthodhokse, dhe, pa as me te voglen mungese, e gjithë djaleria kombtare perpa-rimdashese e Shqiperis.

Ne kete mes e me kete qellim nuk kemi asnje shkak qe te na ndanje ne bijt e popullit; perkun-der, mijera shkakë na shtrengojne te bashkonemi dhe t'i japim do-ren njeri t'jatri. Ky bashkim kombtar do te na ndihmonje t'a zevendesojme "triunfin e legalite-tit" te mizerjes me triumfin e re-volucionit popullor te punes e te bukes, te perparimit e te lumteris. Puna jone drejt ketij qellimi ka per te qene festimi me i bukur qe mund te bejme me rastin e 25 vje-torit te independences shqipetare.

TIRANA NE TYM E TERR TE TIRANIT

HOXE SALI VUÇITERNI, ne rast festimesh, me zotesin e nje perrallazhiu arabistani na ka rre-fyer disa meselera bajagji besa-nike rreth lindjes dhe patriotizmes se birit te Xhemal Pashes. All-llah ile, c'iq-qaj-je do te na nxjerre ne drite per 25-vjetorin?

★

BOZA, PEKMEZIT, per MJAL-TEN: "Nuk me pelqejn' aspake burra shteti, qe nuk u pelqen par-ja dhe ryshfeti"... Doktor mund t'ia perkthenje mikut: Ich ziehe vor nur solche Staatsberater, die Wohlgefallen finden an Bestech-ung."

★

PANDEMONI: "Me pelqejne Kryyeministra mehanexhinj, qer-hanexhinj, dhe hanexhinj qe ka-ne zanat farmakun; Ministra te jashtem, qe m'i nenshkruajne tra-ktatet e fshehte pa guxuar t'i le-qitin; t'arsmit, ata qe i kane zët qitapet dhe kalemin, dhe lajne kembet te shumen d y here ne vjet; te financave, defterdaret e Pallatit; te ekonomis kombtare, qajallaret e mij; te punevet boto-re, qajallaret e qajait t'im; te dre-jtesis, te arratisurit nga drejtesis, qe me legalizojne il-legalitetet; te mbrendeshem, ayqë me qendrom më mbrenda zemres; te mbrojtjes kombtare, kush fshihet ne plevice ne kohe lufte; dhe Mbret"... kush fshihet ne Hobor ne Kohe page, se nuk ka sy e faqe t'i dale po-pullit perparal!

★

PERPARIM! Sultan Hamiti u kishte ndertuar kuajvet t'asqere-vet ne Tirane, ne shekullin e tij merum, nje qilar.. nga "isanlle-ku". Sultan Ahmeti, nga murder lleku, ne shekullin e rilindjes kom-btare, ate qilar ua dha bijvet të popullit peshqesh arsimi për 25-vjetorin e liris shqipetare.

★

NDRYSHIM... Nje bujk nga Kolonja, pesedhjet vjet me pare, ne kohe tiranije, themeloi ne kra-hinen e vet nente shkolla shqipe dhe shkroi nje apologji kunder dhespoterve qe deshen t'ia mbyll-nin ato qendra kombtare qytete-rimi dhe kulture.

Dhespoti i Burelit ne kohen e Dovletit nenshkroi qarkoren e Ma-felit kunder shkronjavet shqipe; sot mban krahinen e Matit pa shkolla, dhe per Njezetepesvjeto-

rin e "Independences" shqipetare mbreterisht e naltmadhenisht si shperblien për çifligjet dhe Saran-den e grabitura i dhuroi popullit të lire te Malesis, "Brgun e Je-tes!"

Leçitesvet te "Vulne-tarit te Lirise"

Leçitesvet te "Vulnetari" u lutemi te na i falin gabimet eshu-meta te ketij numeri te pare. Ra-dhonjesit jane spanjolie qe nuk e dijne gjuhen shqipe; shtypesh-kronjes, njady germa të gjuhës s'onë mungojnë; gjysme e shpar-tallosur nga bombat e gjyllet. qendron vetem disaqind metra

lerk istikamevet te fashistevet. Dushmanevet nuk u-pelqen qe ne te merremi edhe me shtypeshkri-me ne kohe lufte, dhe keshtu per-piqen t'ua prishin gjakun puneto-revet t'ane me anen e Mortarevet dhe te Kapronevet. Por i siguro-jme kendonjesit shqipetare qe, per inat te Morevet flokëzes e floke-verdhe, do te perpiqemi qysh me numurin e dyte t'a botojme "Vul-netarin" sa te jete e mundur pa gabime, me lende te pasur dhe me trajte te bukur.

Dhe presim nga miqt e shokët perkrahjen me te madhe.

SALUDI


DREJTIMI:

VULNETARI I LIRISE

PRENSA — 41

VELAZQUEZ. 63

MADRID



Si dukej kryeqendra e Briga-davet muajin e kaluar kremtimin e aniversarit te dyfishte: e njev-jetorit te mbrojtjes se Madridit

dhe e njetzvjetorit te ngadheni-mevet te Socializmes ne U. R. S. S.

DIANA (U. G. T.). — Larra, G. Madrid